

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË**

**Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit
Seksioni për Monitorim të Sistemit Juridik**

**Gjykimet për Krime Lufte në Kosovë:
Shqyrtim**

shtator 2002

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTESAT	4
PËRMbledhja Ekzekutive	6
I. MANDATI.....	6
RAPORTIMI PUBLIK	6
III. FUSHËVEPRIMI.....	6
IV. VËREJTJET PËRFUNDIMTARE	7
SEKSIONI I. METODOLOGJIA DHE SFONDI INSTITUCIONAL.....	9
I. METODOLOGJIA	9
II. SFONDI DHE ZHVILLIMI I SISTEMIT GJYQËSOR NË KOSOVË DHE RËNDËSIA E SAJ PËR RASTET E KRIMEVE TË LUFTËS	10
SEKSIONI II. PËRMbledhja e Rasteve	12
DRAGAN NIKOLIQ.....	12
LULZIM ADEMI	13
MIROSLAV VUQKOVIQ DHE BOZHUR BISHEVAC.....	14
I MITURI Z	15
ZVEZDAN SIMIQ	16
MILOSH JOKIQ.....	17
AGIM AJETI DHE BOZHIDAR STOJANOVIQ	18
ZORAN STANOJEVIQ	19
IGOR SIMIQ, DRAGAN JOVANOVIĆ, SRGJAN DHE VLASTIMIR ALEKSIĆ, TOMISLAV VUQKOVIQ, DHE BRANISLAV POPOVIQ.....	20
QEDOMIR JOVANOVIQ DHE ANĐELKO KOLLASHINAC.....	20
RADOVAN APOSTOLOVIQ, BOZHUR BISHEVAC, MICKA KRAGOVIQ, BOGOLJUB JEVTIQ, DHE LJUBISHA SIMIQ.....	22
SAVA MATIQ	23
MOMQILLO TRAJKOVIQ	24
BOGOLJUB MISIĆ DHE STOJAN JOVANOVIQ.....	25
ALEKSANDER MLLADENOVIQ.....	26
VESELIN BISHOVIQ.....	27
SASHA GRKOVIQ.....	27
SEKSIONI III. LIGJI I APLIKUESHËM DHE AUTORITETET RELEVANTE.....	29
I. LIGJI I APLIKUESHËM.....	29
<i>Krimet substanciale</i>	29
<i>Ligji mbi përgjegjësinë penale</i>	31
<i>Ligji i procedurës</i>	32
II. AUTORITETET MBI KRIMET E LUFTËS DHE E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE.33	
SEKSIONI IV. ANALIZIMI I RASTEVE	34
I. AKUZIMI	34
<i>Krimet substanciale</i>	34
<i>Organizimi dhe përpilimi i aktakuzave</i>	36
II. AFTËSIA E MBROJTËSVE PËR TË PREZENTUAR PROVAT.....	37
III. AKTGJYKIMET	38
<i>Çështjet e besueshmërisë</i>	38
<i>Teoritë mbi përgjegjësinë penale në kontekstin e Kosovës</i>	42
<i>Struktura dhe rezultatet në aktgjykimet gjyqësore</i>	45
<i>Mungesa e autoiteteve të cituara</i>	46
<i>Kualifikimi jo i saktë i krimit</i>	47

IV. VENDIMET E GJYKATËS SUPREME.....	48
<i>Shqyrtim</i>	48
<i>Trajtimi i Gjenocidit, LP RFJ 141</i>	49
<i>Trajtimi i Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile, LP RFJ 142</i>	50
<i>Trajtimi i përgjegjësisë penale</i>	51
<i>Mungesa e autoriteteve të cituara</i>	52
SEKSIONI V. STATISTIKAT MBI RASTET E KRIMEVE TË LUFTËS.....	53
RASTET E KRIMEVE TË LUFTËS.....	53
AKTGJYKIMET NË RRADHITJEN KRONOLOGJIKE	54
AKTGJYKIMET E GJYKATËS SUPREME NË RRADHITJE KRONOLOGJIKE.....	55
NENET RELEVANTE TË LIGJIT PENAL TË RFJ	55

SHKURTESAT

DAD	Departamenti Administrativ i Drejtësisë
KGJK	Komisioni Këshilldhënës Gjyqësor
DD	Departamenti i Drejtësisë
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
SEGJ	Sistemi Emergjent Gjyqësor
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
LP RFJ	Ligji Penal i RFJ-së
LPP RFJ	Ligji i Procedurës Penale i RFJ-së
DDNJSL	Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit
KNDCP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
GJNPJ	Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë
GJNPR	Gjykata Ndërkombëtare Penale për Ruandën
KPK	Këshilli i Përbashkët Këshilldhënës mbi Emërimet Gjyqësore
NjIGJ	Njësia për Inspektim Gjyqësor
KFOR	Forcat e Kosovës
GJKKLE	Gjykata e Kosovës për Krime Luftë dhe Etnike
SMSJ	Seksioni për Monitorim të Sistemit Juridik
NATO	Organizata e Aleancës Veri-Atlantike
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
KTK	Komiteti Teknik Këshilldhënës i Judikaturës dhe Prokurorisë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

RKS KB	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
Konventa e I-rë e Gjenevës	Konventa e Gjenevës për përmirësimin e kushteve të të plagosurve dhe sëmurëve në forcat e armatosura në fushëbetejë, 12 gusht 1949
Konventa e II-rë e Gjenevës	Konventa e Gjenevës për përmirësimin e kushteve të të plagosurve dhe sëmurëve dhe anëtarëve të anijeve të përmbysura të forcave të armatosura në det, 12 gusht 1949.
Konventa e IV-të e Gjenevës	Konventa e Gjenevës mbi mbrojtjen e personave civil në kohë të luftës, 12 gusht 1949
Protokoli 1	Protokoli Shtesë i Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949, mbi mbrojtjen e viktimave të konfliktit të armatosur ndërkombëtar
Protokoli 2	Protokoli Shtesë i Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949, mbi mbrojtjen e viktimave të konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar, 8 qershor 1977
Konventa mbi Gjenocidin	Konventa mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit, 9 dhjetor 1948

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I. MANDATI

Seksioni për Monitorim të Sistemit Juridik (SMSJ) është pjesë e Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit dhe të të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut) Shtyllës së III (Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë – OSBE). Për dy vjett e kaluara, SMSJ ka ushtruar mandatin e tij në monitorimin e sistemit gjyqësor në Kosovë, promovimin e pajtueshmërisë së tij me standardet vendëse dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe dhënien e rekomandimeve përkitazi me gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për të siguruar që këto standarde të përmbushen. Funksionet monitoruese të SMSJ-së janë përmbushur nga këndvështrimi objektiv, duke iu përshtatur një strategjie të gjithëmbarshme e cila kryesisht kishte për synim dy aspekte themelore: e para, korniza ligjore duhet të jetë në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut, dhe, e dyta, gjykatat duhet në mënyrë konsistente të zbatojnë dhe respektojnë garancat dhe standardet që parashihen me ligjin e zbatueshëm.

II. RAPORTIMI PUBLIK

Në pajtim me mandatin e tij, SMSJ në mënyrë konsistente ka përgatitur dhe lëshuar raporte publike¹ mbi sistemin e drejtësisë penale, të cilat kishin për synim dhënien e ndihmës autoriteteve relevante në fushën e drejtësisë në detyrat e tyre të reformimit dhe sigurimit të pajtueshmërisë së sistemit gjyqësor me standardet e gjykimit të drejtë dhe procesit të rregullt. Në përpjekjet e qëndrueshme për të zhvilluar kapacitetet e tij raportuese, raportet e SMSJ-së vendosin një theks të veçantë mbi çështjet dhe aspektet brengosëse të cilat janë simptomatike për sistemin gjyqësor si tërësi. Për momentin SMSJ-ja fokusohet dhe raporton mbi trendet e përgjithshme që përfaqësojnë shkeljet e instrumenteve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut apo cenime të sundimit të ligjit. Këto rrjedha apo çështje brengosëse sistematike janë duke u analizuar në mënyrë thelbësore, andaj çdo rekomandim eventual, pasi që të implementohet, do të na shpiej drejt zbatimit të reformave efektive dhe gjithëpërfshirëse në lëmitë përkatëse dhe jo kah zgjidhjet e përkohshme.

SMSJ deri më tani ka lëshuar dy lloje të raporteve publike: (Shqyrtimet gjashtëmujore mbi Sistemin e Drejtësisë Penale) dhe raportet speciale. Kategoria e fundit ka adresuar lëmitë specifike në të cilat SMSJ ka fokusuar kapacitetet e tij që janë vënia e theksit të posaçëm mbi komunitetin profesional ligjor dhe atë publik si atë vendës ashtu edhe atë ndërkombëtar.

III. FUSHËVEPRIMI

Ky raport special paraqet një shqyrtim gjithëpërfshirës të të gjitha rasteve në të cilat kryesisht e veprave penale të krimeve të luftës dhe gjenocidit kundër popullatës civile, siç

¹ Raportet janë në dispozicion në ueb-site të OSBE: ëëë.osce.org/kosovo/documents/reports/justice

parashihen edhe me ligjin e zbatueshëm në Kosovë, janë ndjekur penalisht nga sistemi gjyqësor i themeluar nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-un) pas qershorit 1999. Ajo paraqet një vlerësim të parë të plotë të ndjekjeve penale për shkeljet e të drejtës humanitare ndërkombëtare të cilat janë bërë nga sistemi gjyqësor. Këto gjykime janë me rëndësi kryesore për evoluimin e shoqërisë në Kosovë drejt pajtimit dhe njohjes së të vërtetës. Sidoqoftë, informatat publike përkitazi me mënyrën se si këto gjykime janë zhvilluar dhe aktgjykimet, deri më tani kanë qenë të rralla dhe jokonsistente, duke lënë publikun e gjerë si dhe një pjesë të madhe të komunitetit ligjor vendës dhe atij ndërkombëtar me një pasqyrë jo të plotë mbi materialet dhe proceset që kanë të bëjnë me këto raste.

Ky raport del në shesh si një plotësim i informatave dhe analizave të bëra përkitazi me gjykimet për veprat penale të krimeve të luftës të kryera në Kosovë. Fushëveprimi i këtij shqyrtimi është i dyfishtë. Së pari, ai përcakton një vlerësim të plotë mbi procedurat gjyqësore të cilat ishin zhvilluar në këtë drejtim. Së dyti, ajo hulumton dhe analizon aktakuzat, gjykimet, aktgjykimet dhe vendimet e shkallës së dytë. Analizat janë të bazuara në ligjin e zbatueshëm në Kosovë që ka të bëjë me objektin e lëndëve përkatëse, por gjithashtu i vendos gjykimet dhe vendimet në një kontekst më të gjërë të jurisprudencave tjera ndërkombëtare të së drejtës humanitare, e cila gjë zbatohet nga një sërë juridikcionesh të vendeve të ndryshme si dhe nga gjykatat ndërkombëtare penale për Ruandë dhe Ish Jugosllavi.

IV. VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Rezultatet dhe analizat e siguruar në këtë raport na shpiejnë drejt nxjerrjes së një sërë përfundimesh përkitazi me përmbushjen me sukses të detyrave nga ana e gjyqësisë në Kosovë sa i përket aspektit të ndjekjes penale dhe zhvillimit të gjykimeve për rastet e krimeve të luftës në Kosovë. Këto përfundime i referohen si zyrtarëve gjyqësor të kyçur në këto raste ashtu edhe sistemit gjyqësor dhe administruesve të tij. Sa u përket këtyre të fundit, përfundimet kanë natyrë rekomanduese dhe kanë për qëllim dhënien e përkrahjes dhe ofrimin e resurseve për gjykatat që merren me rastet e tilla. Duke adresuar çështjet e natyrës së tillë, jurisprudenca për krimet e luftës në Kosovë mund të arrijë një nivel më të lartë të profesionalizmit, koherencës dhe kualitetit të gjithëmbarshtëm ligjor, në mënyrë që të arrijë qëllimin e saj kryesor i cili është promovimi i të vërtetës dhe pajtimit në Kosovë.

- **Aktakuza** në çdo rast penal paraqet instrumentin ligjor me të cilën i akuzuari vëhet në dijeni për akuzat kundër tij apo saj, dhe për bazat faktike për këto akuza; andaj, aktakuzat duhet të përpilohen në mënyrë të qartë dhe specifike. Aktakuza e organizuar mirë dhe në mënyrë specifike jo vetëm që i mundëson të akuzuarit të përgatisë mbrojtjen e tij apo saj në mënyrë më efektive, por ajo gjithashtu është me rëndësi kritike nëse dëshirojmë të kemi një ndjekje të sukseshme penale. Rëndësia e aktakuzës së strukturuar qartë është e madhe veçanërisht në rastet e ndërlikuara ku pohohen të jenë kryer një sërë veprash penale që për viktime kanë një numër personash gjatë një periudhe të caktuar kohore, siç janë ndjekjet penale për krimet e luftës.

- Aktgjykimet e lëndëve të krimeve të luftës duhet të reflektojnë standardet e larta të jurisprudencës. Aktgjykimet në rastet e kësaj natyre pritet të jenë për nga struktura të qëndrueshme dhe të shoqëruara me arsyetim solid ligjor. Karakteri univerzal i këtyre krimeve si dhe vëmendja e opinionit të cilën ata zakonisht e tërheqin do të thotë se aktgjykimet konsiderohen si trup i mendimeve ligjore, të cilat, me fuqinë e kualitetit të tyre, mund të krijojnë një jurisprudencë të shëndoshë që ka për synim dhënien e udhëzimeve apo ofrimin e referimeve gjatë gjykimeve të ngjashme që pasojnë si dhe për profesionistët ligjor gjatë hulumtimit të rasteve të tilla. Për më tepër, duke pasur parasysh se trupat gjykues që dëgjojnë këto raste përbëhen kryesisht nga gjykatësit ndërkombëtar, standardet e shkrimit ligjor dhe argumentimit duhet të jenë edhe më të larta.
- Gjykata Supreme, në çdo sistem ligjor, luan rolin udhëheqës në sigurimin dhe promovimin e standardeve më të larta të interpretimit dhe arsyetimit ligjor, me fushëveprimin e saj themelor në udhëheqjen e praktikës gjyqësore të të gjitha gjykatave që bijnë në kuadër të jurisdikcionit të saj. Ofrimi i analizave të hollësishme dhe citimi i rasteve relevante apo autoriteteve tjera në vendimet e Gjykatës Supreme do të kishte ndihmuar gjykatësit vendës, prokurorët dhe avokatët që të rrisin kapacitetet e tyre në të kuptuarit e çështjeve ligjore që ngriten gjatë gjykimeve të lëndëve të krimeve të luftës. Ajo gjithashtu është në gjendje të merr vendime që janë më bindëse. Së fundi, vendimet e tilla mund të ndihmojnë në formimin e bazave për krijimin e një jurisprudence më dinamike, kritike dhe të pavarur të gjykatave të Kosovës.
- Nëse dëshirojmë që prokurorët dhe gjykatësit e përfshirë në hetimet dhe gjykimet e rasteve të krimeve të luftës të jenë më të aftë që të ofrojnë analiza të shëndosha dhe të hollësishme, të shoqëruara me studime të gjera të praktikës gjyqësore ndërkombëtare, duhet të kemi një **ndarje të duhur të resurseve për këto raste**. Prokurorëve dhe gjykatësve në fjalë duhet t’ju ofrohet edhe ekipi profesional studiuesve dhe analistëve ligjor, të cilët janë të aftë për të dhënë një kontribut substancial ligjor në përpilimin e aktakuzave dhe aktgjykimeve për këto raste.
- Shumë aktgjykime për krime lufte në Kosovë bazohen në argumente që ndërliken me besueshmërinë e dëshmimeve të dhëna nga dëshmitarët, argumente këto që burojnë nga mospajtueshmëria e deklaratave të dëshmitarëve të njëjtë të dhëna gjatë fazave të ndryshme të procedurës hetimore apo procesit gjyqësor. Për shkak se një theks më i madh është vënë në qëndrueshmërinë e deklaratave të dëshmitarit dhe gjithashtu duke pasur parasysh kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore në këto raste, gjykatat e Kosovës duhet të fusin në përdorim, në të gjitha rastet e krimeve të luftës, **procesverbalet verbatim** (fjalë për fjalë). Në këtë mënyrë, deklaratat dhe vërejtjet e bëra në fazat e ndryshme të gjykimit do të reflektohen në mënyrë besnike në procesverbalin zyrtar të rastit, duke eliminuar çdo argumentim të mëvonshëm mbi atë se a janë mospërputhjet në mes të deklaratave për shkak të pasaktësive në procesverbal apo për shkak të vetë përmbajtjes së deklaratës.

PJESA I. METODOLOGJIA DHE HISTORIKU INSTITUCIONAL

I. METODOLOGJIA

Raporti i tanishëm është i bazuar në informatat e mbledhura gjatë monitorimit të drejtëpërdrejtë nga SMSJ-ja të të gjitha krimeve të luftës të hetuara dhe gjykuara nga gjykatat në Kosovë. SMSJ-ja ishte në gjendje t'i rishikoj të gjitha dosjet e këtyre rasteve dhe gjithashtu të ulet në sallën e gjykimit për të përcjellur në mënyrë efikase të gjitha procedurat e zhvilluara gjatë fazës së gjykimit dhe asaj ankimore të zhvilluar pranë Gjykatës Supreme. Analizat ligjore të materialeve dhe proceseve në këto raste janë të bazuara në aktakuzat, aktgjykimet dhe vendimet aktuale të Gjykatës Supreme, të cilat i kishte në dispozicion të SMSJ-së.

Gjatë tërë raportit, rastet të cilat janë objekt i analizave në përgjithësi do të quhen si "raste të krimeve të luftës". Ky emërtim i përgjithshëm ka për qëllim që të jetë sa më përshkruar, pasi që përfshin jo vetëm rastet e krimeve të luftës kundër popullatës civile, siç parashihet edhe me ligjin e aplikueshëm në Kosovë (Neni 142 i Ligjit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë – LP RFJ), por gjithashtu edhe rasteve tjera të cilat ishin akuzuar sipas Kapitullit 16 të LP RFJ "Veprat Penale kundër Njerëzimit dhe të Drejtës Ndërkombëtare". Për më tepër, ky raport gjithashtu do të përfshijë në shqyrtimin e tij rastet ku pikat e ndryshme të aktakuzës që e ngarkojnë një person për veprë penale të vrasjes apo vepra tjera penale siç është shkatërrimi i pasurisë, plaçkitjet, vjedhjet, lëndimet trupore, ishin ndjekur penalisht jashtë kornizës së Kapitullit 16 të LP RFJ-së. Këto të fundit janë të rëndësishme sidomos nga aspekti i mënyrës me të cilën gjykatat kanë vlerësuar rrethanat faktike gjatë konfliktit të armatosur dhe në bazë të të cilit ato kanë shfrytëzuar mekanizmat dhe bazat e ndryshme për përpilimin e aktakuzës.

Rastet e shqyrtuara në këtë raport përfshijnë veprat penale për të cilat pohohet apo edhe është vërtetuar se janë kryer gjatë periudhës kohore maj 1998 - qershor 1999 gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. Ndjekjet penale për këto vepra filluan me 5 nëntor 1999, kur u ngrit edhe aktakuza e parë, të cilat vazhdojnë edhe sot. Gjykatat që mirren me këto gjykime penale përbëheshin kryesisht nga gjykatës dhe prokurorë vendës apo edhe nga ata ndërkombëtar të emëruar për të ushtruar funksionet e tyre në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës. Me qëllim të kuptimit më të mirë të përbërjes që e kishin në atë kohë trupat gjykues të përfshira në gjykimin e këtyre rasteve, ky raport ofron një historik të shkurtër mbi evoluimin e sistemit gjyqësor në Kosovë nën administrimin e UNMIK-ut, me theks të veçantë në faktorin përcaktues dhe rolin e përfshirjes së gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar në rastet e tilla.

Sa i përket metodës së vlerësimit të rastit që përshkruhet në pjesët vijuese të këtij teksti, ky raport së pari do të prezantoj përshkrimin e fazave procedurale të të gjitha rasteve të analizuara, e pastaj do të vazhdoj me vlerësimin e aspekteve substanciale ligjore në raport me hetimet, ndjekjen, gjykimin dhe rigjykimin. Analizat do të përqëndrohen në rastet individuale në të cilat janë ngritur një sërë çështjesh përkatëse që kanë të bëjnë me identifikimin dhe definimin e elementeve të përgjegjesisë penale, duke vlerësuar provat e

rastit, apo interpretuar dispozitat relevante ligjore për rastin specifik. Ajo gjithashtu ofron vlerësime kolektive dhe analiza të veçorive dhe aspekteve ligjore të cilat janë të përbashkëta për më shumë raste.

Citatet nga aktgjykimet e krimeve të luftës apo aktakuzave janë përdorur gjatë tërë raportit. Pasiqë gjykatat vendëse në Kosovë nuk përdorin një sistem uniform të emërimit të rasteve dhe formës së zakonshme të aktgjykimeve (me numër të seksionit, paragrafe, etj), këto citate do të paraqiten vetëm nëpërmjet të emrit të rastit, që përshkruhet me emrin e të pandehurit, pa ndonjë referim tjetër shpjegues të paraqitur në fund të faqes.

II. HISTORIKU DHE ZHVILLIMI I SISTEMIT GJYQËSOR NË KOSOVË DHE RËNDËSIA E TIJ PËR RASTET E KRIMEVE TË LUFTËS

Kur UNMIK-u arriti në Kosovë në qershor 1999 pas konfliktit të armatosur dhe fushatës së bombardimeve të NATO-s, nuk kishte sistem funksionues gjyqësor. Këshilli i Përbashkët Këshilldhënës për Emërimet e Përkohshme Gjyqësore (KPK) ishte themeluar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më 28 qershor 1999 për të rekomanduar emërimet e përkohshme të gjykatësve dhe prokurorëve për sistemin emergjent gjyqësor (SEGJ). Me vendimin të PSSP-së, KPK-ja ishte shpërndarë më 7 shtator 1999 dhe ishte zëvendësuar me Komisionin Gjyqësor Këshilldhënës (KGJK), i cili filloi aktivjetin e tij më 27 tetor 1999. Pas procedurës së selektimit dhe emërimit, në qershor 2000, u vendos një sistem i rregullt dhe funksional gjyqësor që do të merrej me rastet penale, në tërë Kosovën.

Përkundër rithemelimit të suksesshëm të sistemit gjyqësor për më pak se një vit dhe përpjekjeve të mëdha të bëra për zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit gjyqësor, ende ekzistojnë një sërë problemesh që nuk janë zgjidhur ende. Niveli i ultë i pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komuniteteve minoritare – posaçërisht serbëve të Kosovës – në sistemin gjyqësor, së bashku me klimën e gjatë të tensioneve ndëretnike, kanë ndikuar në lindjen e problemeve që kanë të bëjnë me animet në gjyqësi sidomos kur kemi të bëjmë me rastet që përfshijnë pjesëtarët e komunitetit serb. Një çështje e tillë u bë veçanërisht akute sidomos kur kemi të bëjmë me kapacitetet e gjyqësisë vendëse që në mënyrë të duhur dhe të paanshme të hetojë dhe gjykojë rastet që përfshijnë pjesëtarët e komuniteteve minoritare, të implikuar në krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur, në mes të vjeshtës 1998 dhe pranverës 1999.

Me qëllim të adresimit të shqetësimeve që kanë të bëjnë me animet në baza etnike në rastet e krimeve të luftës apo, në përgjithësi në të gjitha rastet e dhunës ndëretnike, dhe si përgjigje ndaj trazirave publike dhe dhunës që shpërtheu në Mitrovicë në shkurt 2000, PSSP-ja nxjerri Rregulloren e UNMIK-ut 2000/6 e cila parasheh emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar në Mitrovicë.² Më 29 maj 2000, pas presionit nga pjesëmarrësit në grevën e urisë në Mitrovicë, shumica prej të cilëve ishin të paraburgosur serb të Kosovës dhe të cilët ishin në hetime apo ishin në pritje të gjykimeve për krime lufte, PSSP-ja nxjerri Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/34 me të cilën zgjerohen

² Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 Mbi emërimin dhe largimin nga zyra e gjykatësve ndërkombëtar dhe prokurorëve, 15 shkurt 2000.

kompetencat e tij për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar në tërë territorin e Kosovës.³

Këto emërimet fillestare të personelit ndërkombëtar nëpër gjykata ndihmuan në masë të madhe në mënjanimin e disa problemeve që kishin të bëjnë me paanshmërinë nëpër gjykata. Sidoqoftë, duke pasur parasysh numrin e kufizuar të gjykatësve ndërkombëtar dhe brezin e ngushtë të kompetencave të tyre, emërimet dështuan që në mënyrë të plotë të adresojnë shqetësimet në lidhje me paanshmërinë dhe si rezultat i kësaj kishim trajtimin e ndryshëm të rasteve të ngjashme. Të pandehurit të cilët ishin akuzuar për krime lufte apo krime me motive etnike me natyrë dhe peshë të ngjashme me ato që ishin gjykuar nga trupat gjykues me përbërje të përzier. Disa ishin në përbërje nga të gjithë gjykatës shqiptar të Kosovës, derisa disa të tjerë përbëheshin edhe nga gjykatës ndërkombëtar . Për më tepër, trupat gjykues të gjykatave të qarkut, sipas ligjit vendës, përbëheshin kryesisht nga dy gjykatës profesional dhe tre gjykatës porotë;⁴ përderisa aktgjykimet biheshin me shumicë të votave dhe vota e secilit gjykatës ishte e barabartë.⁵ Shpërndarja e barabartë e pushtetit votues të të gjithë gjykatësit e zvogëloi në masë të madhe ndikimin që gjykatësit ndërkombëtar mund të kishin në pruarjen e mundshme të aktgjykimit të motivuar nga animet në baza etnike. Në këtë drejtim, roli i ushtruar nga gjykatësi i parë ndërkombëtar ishte i pamjaftueshëm për të përmirësuar mungesën e dukjes objektive të paanshmërisë në gjykimet që kyqnin raportimet për krime serioze të luftës.

Një hap tjetër i rëndësishëm për adresimin e këtyre shqetësimeve u morr me nxjerrjen e Rregullores së UNMIK-ut 2000/64, më 15 dhjetor 2000.⁶ E paraparë të jetë një mjet që do të luftojë dyshimet e lindura për animet e mundshme etnike, Rregullorja u jepte prokurorëve përkatës, të akuzuarve apo avokatëve mbrojtës të drejtën për ankesë pranë Departamentit Administrativ të Drejtësisë (DAD⁷) kundër vendimit mbi caktimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar apo ndryshimin e vendit të gjykimit, nëse një gjë e tillë konsiderohet si e “*domosdoshme për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësisë apo administrimin e duhur të gjyqësisë.*” Në mungesë të ankesës, DAD/DD mund gjithashtu të veprojnë me iniciativë të saj.⁸ Në të dyja rrethanat, DAD/DD do t’i bëjë rekomandim PSSP-së, i cili mëtutje do të vendos mbi caktimin e prokurorit apo trupit gjykues i cili do të përbëhet kryesisht nga gjykatës ndërkombëtar për një rast të caktuar.

Pas plotfuqishmërisë së Rregullores së lartpërmendur, të gjitha rastet e krimeve të luftës ishin mbajtur para trupave gjykues të përbërë nga shumica gjykatës ndërkombëtar, përderisa ndjekja penale në të shumtën e rasteve ishte inicuar nga prokurorët ndërkombëtar.

³ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/34 mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/6 mbi emërimin dhe shkarkimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar, 29 maj 2000.

⁴ Neni 23 LPP RFJ.

⁵ Neni 116 LPP RFJ.

⁶ Me qëllim të diskutimit të mëtutjeshëm të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64, shih Rportin e dytë me rradhë të OSBE-së mbi sistemin e drejtësisë penale, 1 shtator 2000-28 shkurt 2001, f. 75 ff.

⁷ Tani, në kuadër të Shtyllës së i-rë, Departamenti i Drejtësisë (DD) është duke e përmbushur mandatin e tij të paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64.

⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64, neni 1(2).

PJESA II. PËRMBLEDHJE E RASTEVE

Kjo pjesë ngërthen në veti një përmbledhje gjithëpërfshirëse mbi mbarëvajtjen e procedurave gjyqësore për të gjitha rastet që bijnë në domenin studiuës të këtij raporti. Në këtë raport gjithashtu janë të paraqitura gjithsejt 17 raste, dhe ato paraqesin të gjitha gjykimet e krimeve të luftës të cilat janë mbajtur deri në fund të qershorit 2002. Të gjitha këto raste në mënyrë të drejtëpërdrejtë ishin të monitoruara nga OSBE-ja. Rastet e paraqitura në vijim janë të rradhitura sipas datave të ngritjes së aktakuzave.⁹

DRAGAN NIKOLIQ

Grupi etnik i të pandehurit: Serb i Kosovës
Gjykata: Gjykata e Qarkut në Gjilan

Historia e rastit:

Gjykimi i parë

Data e aktakuzës: 5 nëntor 1999
Akuza nga aktakuza: Vrasje, LPK 30
Prokurori: Vendës
Përbërja e kolegjit: të gjithë vendës
Aktgjykimi: fajtor për vrasje, LPK 30

Procedura ankimore:

Prokurori: vendës (prokurori nuk u paraqit në shqyrtimin gojor para Gjykatës Supreme)
Përbërja e kolegjit: të gjithë ndërkombëtarë
Vendimi: vendimi mbi fajësinë e të pandehurit priset

Rigjykimi

Prokurori: ndërkombëtar
Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtarë
Aktgjykimi: Lirohet

Aktakuza kundër **Dragan Nikoliqit** pandeh se më 5 prill 1999, ai së bashku me një grup prej shtatë ushtarakësh tjerë Serb dhe personelin policor të armatosur me armë automatike, kanë hyrë në banesën e një familje të shqitarëve të Kosovës, kanë urdhëruar familjen të dalin jashtë, kanë kërkuar të holla dhe armë, dhe pastaj kanë ndarë një anëtarë mashkull të familjes dhe kanë shtier me armë në të duke e vrarë atë mëpastaj.

⁹ Gjykatat kosovare nuk kanë sistem të shtypjes së datave dhe kohës në dokumente me rastin e parashtrimit të tyre. As nuk ekziston ndonjë procedurë e rregullt për gjykatës që me shkrim do të bënte me dije se kur një dokument është pranuar. Dokumentet në dosjet e gjykatave përmbajnë zakonisht vetëm datat të shkruara parashtruesi. Andaj, datat e dhëna në këtë seksion përkitazi me atë se kur janë ngritur aktakuzat janë të bazuara në datat të cilët prokurorët i kanë vënë në ato dokumente. Kjo nuk i përgjigjet datës kur aktakuzat ishin pranuar në gjykatë. Gjithashtu, data që paraqitet në aktgjykime apo vendime është data në të cilën gjykata merr vendimin e saj gojor nëpërmjet të trupit gjykues, edhe pse aktgjykimet me shkrim zakonisht lëshohen në disa javë apo muaj më vonë.

Gjykimi i Nikoliqit u mbajt në mes të 18 majit 2000 dhe 3 korrikut 2000. Nikoliqi paraqiti mbrojtjen nga alibi. Trupi gjykues e shpalli atë fajtor sipas akuzës dhe e dënonte me 12 vjet e 6 muaj burgim.

Sipas ankesës së mbrojtjes, më 9 prill 2001 Gjykata Supreme e prishi vendimin dhe e ktheu rastin prapa për rigjykim duke u bazuar në (1) vertetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, dhe (2) refuzimin e gjykatës për të dëgjuar dëshmitarët serb dhe kroat të propozuar si dëshmitarë të mbrojtjes.

Rigjykimi filloi më 12 shtator 2001 para trupit gjykues të përbërë nga shumica gjykatës ndërkombëtar. Nikoliqi mbështeti mbrojtjen e tij nga alibi. Kolegji e shpalli të pafajshëm më 18 prill 2002.

LULZIM ADEMI

Grupi etnik i të pandehurit: shqiptar i Kosovës
Gjykata: Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

Historia e rastit:

Gjykimi

Data e aktakuzës: 23 nëntor 1999

Akuza nga aktakuza: *Krime Luftë*, LPJ 142; *Vrasje*, LPK 30(2), *Armëmbajtje pa leje*, LPK 199(3)

Prokurori: Vendës

Përbërja e kolegjit: shumica vendës

Aktgjykimi: fajtor për Krime luftë dhe Armëmbajtje pa leje; i liruar për Vrasje

Procedura ankimore interlokutore:

Përbërja e kolegjit: të gjithë vendës

Vendimi: vendimi i gjykatës për të gjykuar të pandehurin në mungesë, aprovohet

Aktakuza kundër Lulzim Ademit pandeh, përkitazi me akuzat e krimeve të luftës, se në katër data specifike në prill dhe maj 1999, derisa ishte rreshtuar në rradhët e paramilitarëve, Ademi kishte marrë pjesë me forcat paramilitare në shpërnguljen e qytetarëve nga banesat e tyre, në djegjen e shtëpive, dhe vrasjen e 12 njerëzve. Sa i përket akuzës për vrasje, aktakuza pandeh se më 26 janar 1999 i pandehuri së bashku me tre persona të panjohur, ka kidnapuar dhe vrarë një mashkull të moshës madhore. Sa i përket akuzës për armëmbajtje pa leje, aktakuza pandeh se më 11 korrik 1999 Ademi ka pasur në posedim, në banesën e tij, dy pushkë automatike, dy revole, municion të ndryshëm, dhe një granatë.

Ademi qëndroi në paraburgim nga 11 korriku 1999 gjer më 24 shkurti 2000, kur iku nga paraburgimi. Gjykata vendosi, më 3 korrik 2000, që ta gjykonte të pandehurin në mungesë, në pajtim me nenin 3000 të LPP RFJ. Avokati mbrojtës u ankua kundër këtij

vendimi, mirëpo më 12 korrik 2000, Gjykata Supreme vendosi që gjykimi mund të vazhdojë edhe në mungesë të të pandehurit.

Kolegji zhvilloi gjykimin e Ademitit, prej 3 korrikut deri më 30 gusht 2000. Mbrojtësit e Ademit paraqitën mbrojtjen duke u mbështetur në mungesën e identifikimit të të pandehurit, alibinë e tij, dhe provat e pamjaftueshme. Më 30 gusht 2000, kolegji e shpalli Ademin fajtor për krime lufte dhe armëmbajtje pa leje, dhe e liroi nga akuza për vrasje. Kolegji e dënoi Ademin me 20 vjet burg.

As prokurori e as i pandehuri nuk u ankuan kundër aktgjykimit apo kohëzgjatjes së dënimit. Vendqëndrimi i Ademit mbetet, gjer më sot, i panjohur.

MIROSLAV VUQKOVIQ dhe BOZHUR BISHEVAC

Grupi etnik i të pandehurit Vuqković: Serb i Kosovës

Grupi etnik i të pandehurit Bishevac: Serb i Kosovës

Gjykata: Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

Historia e rastit:

Gjykimi i parë(për Vuqković dhe Bishevac)

Data e aktakuzës: 29 nëntor 1999

Aktakuza fillestare: *Gjenocid*, LP RFJ 141

Prokurori: Vendës

Përbërja e kolegjit: shumica vendës

Aktgjykimi: Vuqković shpallet fajtor për *gjenocid*

Procedura ankimore gjyqësore(për Vuqkovićin)

Prokurori: prokurori vendës i zëvendësuar nga prokurori ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtar

Vendimi: vendimi priset

Rigjykimi (i Vuqkovićit)

Aktakuza e parë e ndryshuar: *Krime lufte*, LP RFJ 142

Prokurori: ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtarë

Statusi në gjykatë: në zhvillim e sipër

Aktakuza fillestare kundër Miroslav Vuqkovićit dhe Bozhur Bishevacit pandehte se në periudhën në mes të 22 marsit 1999 gjer në fillim të majit 1999, të pandehurit, “ me qëllim të zhvendosjes së popullatës shqiptare me dhunë dhe me qëllim të shkatërrimit të plotë apo të pjesërishtëm të komunitetit shqiptar”, djegën shtëpi, shtien me armë në fshatarë për t’i shtyer me forcë ata që t’i lëshojnë shtëpitë e tyre, duke konfiskuar pronat e tyre mëpastaj. Sipas aktakuzës, një fshatë e moshuar e cila ndodhej brenda shtëpisë së saj, e paaftë për tu larguar në kohën kur të pandehurit i vunë zjarrin shtëpisë së saj, ishte djegur për vdekje.

Gjykimi filloi më 6 qershor 2000. Në gusht 2000 Bishevac iku nga paraburgimi, por kolegji vazhdoi të zhvillojë gjykimin në mungesë të tij. Më 12 janar 2001 Rregullorja e

UNMIK-ut 2001/1, e cila ndalonte gjykimet në mungesë për shkeljet serioze të së drejtës humanitare ndërkombëtare, hyri në fuqi, dhe gjykata pezulloi ndjekjen ndaj të pandehurit Bishevac.

Gjatë gjykimit, i pandehuri Vučković paraqiti mbrojtjen nga alibi. Më 18 janar 2001 kolegji shpalli Vučkovićin fajtor sipas akuzës për gjenocid dhe e dënonte me 14 vjet burgim.

Sipas ankesës së mbrojtjes, Gjykata Supreme më 9 prill 2001, e prishi aktgjykimin mbi bazat se (1) faktet nga gjykimi nuk mbështesin fajësinë për gjenocid, (2) gjykata ka vlerësuar provat në mënyrë të pasaktë, dhe (3) gjykata ka refuzuar të dëgjoj dëshmitarët e propozuar të mbrojtjes.

Rigjykimi i rastit filloi më 4 janar 2002. Në fillim të rigjykimit prokurori ndërkombëtar paraqiti aktakuzën e ndryshuar e cila akuzonte Vučkovićin për krime lufte. Gjykimi është në zhvillim e sipër; Vučković mohon akuzat e pandehura në aktakuzë, dhe prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij.

I MITURI Z

Grupi etnik i të miturit: Serb i Kosovës
Gjykata: Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

Historia e rastit:

Gjykimi

Data e aktakuzës: 23 dhjetor 1999

Aktakuza fillestare: *Gjenocid*, LP RFJ 141

Prokurori: prokurori vendës (parashtrori fillimisht aktakuzën) i zëvendësuar nga prokurori ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: të gjithë vendës

Aktakuza e ndryshuar (e parashtruar nga prokurori ndërkombëtar): *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*, LPK 157; *Akte të rënda kundër sigurisë së përgjithshme*, LPK 164

Vendimi: gjykohet me masa edukuese

Procedura ankimore gjyqësore

Prokurori: vendës (prokurori nuk u paraqiti në procedurën pranë Gjykatës Supreme)

Përbërja e kolegjit: të gjithë vendës

Vendimi: vendimi i gjykatës dhe dënimi aprovohet.

Propozimi për shqiptimin e masave edukuese (që vlen për kryesit e veprave penale që janë të mitur), pohon se që nga fundi i marsit e gjer në maj 1999, I mituri Z, një mashkull Serb 15 vjeçar, në bashkëpunim me persona madhorë, e me “qëllim të zhvendosjes me dhunë të shqiptarëve dhe shkatërrimit të tyre të plotë apo të pjesërisht”, ka kërcënuar pronarët e shtëpive dhe pastaj ka djegur përafërsisht 100 shtëpi.

Gjykimi filloi më 15 gusht 2000. Provat përfshinin deklaratat e të miturit të dhëna hetuesve të KFOR-it. Në deklaratën e tij fillestare dhënë para hetuesve, i mituri kishte pranuar se kishte djegur tri shtëpi, dhe se kishte qenë prezent kur bashkëkryesit e veprës penale të gjithë madhorë kishin djegur edhe 30 të tjera. Në deklaratën e dytë dhënë hetuesve, i mituri deklaroi se deklarata e tij e mëparshme është nxjerrë nga ai nën premtimin se do të lirohet nëse e pranon fajin.

Më 13 shtator 2000, kolegji morri vendim në favor të shqiptimit të masave edukuese korrektuese për të miturin Z. Ndonëse edhe prokurori publik ndërkombëtar edhe avokati mbrojtës i rekomanduan gjykatësit që i mituri të lirohet nga paraburgimi, kolegji e dënoi me vuajtje të dënimit në shtëpinë korrektuese për të mitur në kohëzgjatje prej 1 deri në 5 vjet.

Pas ankesës së mbrojtësit, më 8 mars 2001, kolegji vendës i Gjykatës Supreme, vërtetoi aktgjykimin.

ZVEZDAN SIMIQ

Grupi etnik i të pandehurit: serb i Kosovës
Gjykata: Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

Historia e rastit:

Gjykimi

Data e aktakuzës: 26 janar 2000

Akuza nga aktakuza: *Vrasje*, LPK 30; *Armëmbajtje pa leje*, LPK 199

Prokurori: vendës

Përbërja e kolegjit: shumica vendës

Aktgjykimi: fajtor për *Vrasje*, LPK 30, dhe *Armëmbajtje pa leje*, LPK 199

Procedura ankimore gjyqësore:

Prokurori: vendës

Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtar

Vendimi: vërtetohet vendimi; aprovohet ankesa e prokurorit për rritjen e dënimit

Aktakuza kundër Zvezdan Simiqit pandeh se më 27 shtator 1998, ai ishte anëtar i grupit të uniformuar të forcave ushtarake dhe policore të cilat hynë në fshat dhe i vunë zjarrin me qëllim të frikësimit të fshatarëve për të ikur. Ajo më tej pohon se i pandehuri së bashku me dy individë të tjerë në uniforma policore, pasi që kishin vërejtur një mashkull shqiptar të Kosovës dhe nënën e tij të moshuar, iu dalin përpara dhe i qëllojnë për vdekje. Dhe në fund, aktakuza deklaroi se më 29 korrik 1999, Gjendarmeria Franceze bastisi banesën e Simiqit dhe gjeti një sasi të madhe të armatimit dhe municionit.

Gjykimi i Zvezdan Simiqit u zhvillua nga 1 deri më 9 gusht 2000. Simiqi mbështeste mbrojtjen nga alibia përkitazi me akuzën për vrasje, dhe, sa i përket akuzës për armëmbajtje pa leje, ai deklaroi se disa nga armët e gjetura në banesën e tij u takonin anëtarëve të tjerë të familjes, dhe se ato që ishin të tijat ai i shfrytëzonte vetëm për gjyete

apo vetëmbrojtje. Kolegji e shpalli Simiqin fajtor sipas akuzës dhe e dënoi me 8 vjet e 4 muaj burgim.

Më 6 qershor 2001 kolegji në përbërje nga shumica gjykatës ndërkombëtarë i Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetoi fajësinë e të pandehurit, dhe aprovoi ankesën e prokurorit për rritje të dënimit deri në 12 vjet.

MILOSH JOKIQ

Grupi etnik i të pandehurit: serb i Kosovës
Gjykata: Gjykata e Qarkut në Gjilan

Historia e rastit:

Gjykimi i parë

Data e aktakuzës: 25 shkurt 2000

Akuza fillestare nga aktakuza: *Gjenocid*, LP RFJ 141

Prokurori: Vendës

Përbërja e kolegjit: shumica vendës

Aktakuza e parë e ndryshuar: pohimet për dhunim të përfshira brenda akuzës për Gjenocid

Aktgjykimi: fajtor për krime lufte, LP RFJ 142

Procedura ankimore gjyqësore:

Prokurori: vendës

Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtar

Vendimi: rasti kthehet në rishqyrtim

Rigjykimi

Aktakuza e dytë e ndryshuar: *Krime lufte*, LP RFJ 142

Prokurori: ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtarë

Aktgjykimi: Lirohet nga të gjitha pikat e aktakuzës.

Milosh Jokiqi ishte akuzuar për një pikë të gjenocidit më 25 shkurt 2000 në Gjykatën e Qarkut në Gjilan. Aktakuza pohon se aktet në vijim përbënin veprë penale të gjenocidit: (1) Më 8 maj Jokiqi së bashku me nëntë paramilitarë tjerë, kishte shtënë me armë zjarri në ajër duke shkaktuar panik e cila solli gjer tek shpërngulja e 2000 banorëve të fshatit Vrbani; (2) Më 9 maj 1999 Jokiqi përdori pushkën automatike për të vrarë një mashkull Shqiptar; (3) Më 15 prill 1999 Jokiqi i urdhëroi një anëtar të grupit paramilitar për të ekzekutuar një mashkull shqiptar të Kosovës, dhe (4) më 30 maj 1999, Jokiqi dhunoi një femër shqiptare të Kosovës.

Gjykimi i Jokiqit u zhvillua në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, në mes të 15 majit dhe 20 shtatorit 2000, para kolegjit me shumicën gjykatës vendës (dhe me një gjykatës ndërkombëtar), dhe me prokurorin publik vendës. Në ditën e parë të gjykimit prokurori paraqiti aktakuzën e ndryshuar e cila përfshinte pohimet për dhunim të një femre shqiptare të Kosovës. Jokiqi paraqiti mbrojtjen e tij nga alibia. Kolegji e gjykoi Jokiqin për krime lufte, LP RFJ 142, dhe e dënoi me njëzet vjet burgim.

Sipas ankesës së mbrojtjes, më 26 prill 2001 Gjykata Supreme e ktheu vendimin në rishqyrtim, sipas dy bazave: (1) gjykata ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve, dhe (2) dëshmitarët Serb të cilët nuk kishin marrë pjesë në gjykimin e parë, duhet të dëgohen. Rasti ishte kthyer për rishqyrtim në Gjykatën e Qarkut në Gjilan.

Kolegji në përbërje shumica ndërkombëtar së bashku me prokurorin ndërkombëtar zhvilluan rigjykimin e rastit. Gjatë tërë rigjyimit i pandehuri mbështeste mbrojtjen e tij nga alibia. Më 3 maj 2002, kolegji e shpalli Jokiqin të pafajshëm në bazë të gjitha pikave të aktakuzës.

AGIM AJETI dhe BOZHIDAR STOJANOVIQ

Grupi etnik i të pandehurit Ajeti:	rom i Kosovës
Grupi etnik i të pandehurit Stojanoviç:	serb i Kosovës
Gjykata:	Gjykata e Qarkut në Gjilan

Historia e rastit:

Gjykimi i parë

Data e aktakuzës:	28 shkurt 2000
Akuza fillestare nga aktakuza:	<i>Vrasje</i> , LPK 30
Prokurori:	Vendës
Përbërja e kolegjit:	shumica vendës
Aktgjykimi:	fajtor për <i>Vrasje</i> , LPK 30

Procedura ankimore gjyqësore:

Prokurori:	vendës
Përbërja e kolegjit:	shumica ndërkombëtar
Vendimi:	rasti kthehet në rishqyrtim

Rigjykimi (vetëm për Stojanoviçin)

Prokurori:	ndërkombëtar
Përbërja e kolegjit:	shumica ndërkombëtar
Statusi i gjyimit:	në zhvillim e sipër

Aktakuzat kundër Agim Ajetit dhe Bozhidar Stojanoviçit pohojnë se me 15 prill 1999 të pandehurit ishin anëtarë të një grupi Serb paramilitarësh të cilët hynë në fshat, dëbuan banorët nga banesat e tyre, dhe ndanë meshkujt nga femrat. Aktakuza gjithashtu deklaroi se të pandehurit e ndanë një mashkull Shqiptar, dhe e shpuan me bajonetë gjer në vdekje.

Gjykimi i Ajetit dhe Stojanoviçit u zhvillua në mes të 7 korrikut dhe 9 tetorit 2000 (Ajeti ishte gjykuar në mungesë, dhe ishte përfaqësuar nga avokati gjatë tërë procedurës). Të dy të pandehurit mbështetën mbrojtjen nga alibia dhe provat e pamjaftueshme. Kolegji e gjykoi Ajetin dhe Stojanoviçin sipas akuzës për vrasje. Ata dënuan Ajetin me 10 vjet burgim e Stojanoviçin me 16 vjet burgim.

Sipas ankesës së mbrojtjes, Gjykata Supreme me 29 nëntor 2001, e ktheu rastin në rishqyrtim sipas bazave në vijim: (1) gjykata nuk kishte vërtetuar faktet në mënyrë të mjaftueshme; (2) nuk ishin ftuar dëshmitarët e mbrojtjes që jetonin në Serbi (këtu Gjykata Supreme kishte cituar KEDNJ nenin 6(3)); (3) dokumentacioni i prezentuar nga mbrojtja nuk ishte pranuar; (4) gjykata dështoi të sqarojë kontradiktat që ekzistonin në dëshmitë e dëshmitarëve dhe të pandehurve. Gjykata Supreme gjithashtu mori parasysh, pa u deklaruar, se Rregullorja e UNMIK-ut 2001/1 tanimë ndalonte që i pandehuri Ajeti të gjykohej në mungesë.

Më 30 maj 2002 kolegji me shumicë ndërkombëtare vendosi që të mos rigjykonte Ajetin në mungesë. I njëjti kolegji filloi gjykimin kundër Stojanoviçit, dhe procedura është në zhvillim e sipër. Stojanoviçi mohon akuzat, dhe konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij.

ZORAN STANOJEVIQ

Grupi etnik i të pandehurit: serb i Kosovës
Gjykata: Gjykata e Qarkut në Prishtinë

Historia e rastit:

Gjykimi

Data e aktakuzës: 9 maj 2000

Akuza nga aktakuza: *Vrasje*, LPK 30 (1) (një pikë)

Prokurori: aktakuza e paraqitur nga prokurori vendës; procedura gjyqësore e zhvilluar nga prokurori ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: shumica vendës

Aktakuza plotësuese: *Vrasje në tentativë*, LPK 30 (1) dhe LP RFJ 19 (dy pika)

Aktgjykimi: fajtor siç akuzohet

Procedura ankimore gjyqësore:

Prokurori: ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtar

Vendimi: vërtetohet aktgjykimi dhe dënimi

Aktakuza kundër Zoran Stanojeviçit pohon se më 15 janar 1999, ai ishte anëtar i grupit të policëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të RFJ-së të cilët morrën pjesë në shtierjen me armë në civilë derisa ata tentonin të iknin nga fshati Reçak.

Gjykimi, fillimisht, i caktuar për korrik 2000, ishte shtyrë për shkak të mosparaqitjes së dëshmitarëve. Gjykimi, më në fund, filloi para kolegjit me shumicë ndërkombëtare më 6 janar 2001. Më 6 shkurt 2001 avokati i cili përfaqësonte dy palët e dëmtuara, duke vepruar si prokuror privat, parashtrori aktakuzën e cila akuzonte Stanojeviçin me dy pika plotësuese të tentim-vrasjes (këto dy pika burojnë nga i njëjti incident sikurse dhe aktakuza fillestare). Gjykata i konsolidoi të dy aktakuzat për gjykim.

Stanojeviç, fillimisht, prezantoi mbrojtjen e tij nga alibia. Sidoqoftë, avokati i tij mbrojtës gjithashtu pohoi se, edhe po të supozohej se dëshmitarët e ndjekjes janë të besueshëm,

rasti duhej të ishte bazuar në akuzat për krime lufte në vend se për vrasje, dhe se Stanojeviq si ushtarak i rangut të ultë, nuk ishte përgjegjës për krimet e kryera nga shteti.

Më 18 qershor 2001 kolegji e shpalli të pandehurin fajtor sipas akuzës për një pikë të vrasjes dhe dy pika të tentim vrasjes, dhe e dënoi atë me 15 vjet burgim.

Më 18 qershor 2002, kolegji i Gjykatës Supreme në përbërje shumica ndërkombëtar vërtetoi aktgjykimin dhe dënimin.

IGOR SIMIQ, DRAGAN JOVANOVIQ, SRGJAN DHE VLASTIMIR ALEKSIÇ, TOMISLAV VUQKOVIQ, dhe BRANISLAV POPOVIQ

Grupi etnik i të pandehurve: të gjithë serb të Kosovës
Gjykata: Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

Historia e rastit (vetëm për Igor Simiqin):

Gjykimi

Data e aktakuzës: 20 qershor 2000

Akuza nga aktakuza: *Gjenocid*, LP RFJ 141

Prokurori: fillimisht prokurori vendës i zëvendësuar nga prokurori ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: shumica vendës

Dispozitivi: Ndjekja është pezulluar nga prokurori ndërkombëtar

Aktakuza e datës 20 qershor 2000 i ngarkonte **Igor Simiqin, Dragan Jovanoviqin, Srgjan Aleksiqin, Tomislav Vuqkoviqin, Vlastimir Aleksiqin dhe Branislav Popoviqin**

me gjenocid. Aktakluza pohonte se, me qëllim “që pjesërisht apo plotësisht të shkaëtrronin apo zhvendosnin komunitetin shqiptar jashtë Mitrovicës (sic), e nga kjo jashtë Kosovës” (1) më 14 prill 1999 të gjithë gjashtë të pandehurit derisa ishin të armatosur dhe të uniformuar me uniforma kamuflazhe, kanë vrarë 26 civilë shqiptarë të Kosovës; (2) në mes të marsit dhe majit 1999, të pandehurit Jovanoviq dhe Vuqkoviq dhunshëm kanë zhvendosur shqiptarët e Kosovës nga shtëpitë dhe punëtoritë e tyre, e pastaj kanë plaçkitur dhe djegur pronat e tyre; (3) më 22 maj 1999 i pandehuri Jovanoviq ka dëbuar civilët, ka konfiskuar gjërat e vlefshme nga ata, e pastaj shtëpive të tyre ua ka vënë zjarrin; dhe (4) më 15 qershor 1999 Jovanoviqi, së bashku me dy bashkëkryes tjerë të panjohur, ka shtënë dhe ka vrarë në çift shqiptar në shtëpinë e tyre, e pastaj shtëpisë ia ka vënë zjarrin.

Në gusht 2000 të pandehurit Dragan Jovanoviq, Srgjan dhe Vlastimir Aleksiq, Tomislav Vuqkoviq, dhe Branislav Popoviq kanë ikur nga Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë. Ata nuk janë gjykuar, as personalisht e as në mungesë.

Më 5 dhjetor 2000 filloi gjykimi i Simiqit para kolegjit me shumicë gjykatës vendës dhe me një gjykatës ndërkombëtar. Simiqi mbështeste mbrojtjen nga alibia. Më 10 prill 2001 prokurori ndërkombëtar paraqiti deklaratën e cila e njoftonte kolegjin se ai hiqte dorë nga ndjekja. Njoftimi i prokurorit ndërkombëtar i bërë kolegjit njoftonte se provat nuk ishin të

mjaftueshme për të vërtetuar se Simiqi ka kryer ndonjë vepër penale e cila mund të ndjeket penalisht, më 14 prill 1999.

ÇEDOMIR JOVANOVIQ dhe ANGJELLKO KOLLASHINAC

Grupi etnik i të pandehurit Jovanoviq: serb i Kosovës
Grupi etnik i të pandehurit Kollashinac: serb i Kosovës
Gjykata: Gjykata e Qarkut në Prizren

Historia e rastit:

Gjykimi i parë

Data e aktakuzës: 7 gusht 2000
Akuza fillestare nga aktakuza: *Krime lufte*, LP RFJ
Prokurori: Vendës (paraqiti aktakuzën) i zëvendësuar nga ndërkombëtari
Përbërja e kolegjit: të gjithë ndërkombëtar
Aktgjykimi: I pandehuri Jovanoviq u shpall fajtor për *Krime lufte*, LP RFJ 142
I pandehuri Kollashinac u shpall fajtor për *dhënien e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale*, LPK 174(1) dhe (3)

Procedura ankimore gjyqësore:

Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtar
Prokurori: vendës
Vendimi: Aktgjykimi dhe dënimi në rastin e të pandehurit Jovanoviq vërtetohet
Aktgjykimi dhe dënimi në rastin e të pandehurit Kollashinac kthehet në rishqyrtim

Rigjykimi (i të pandehurit Kollashinac)

Statusi i gjykimit: gjykimi ende nuk ka filluar

Aktakuza e datës 7 gusht 2000 e ngarkon *Qedomir Jovanoviqin, Angjellko Kollashinacin, Nenad Matiqin, Vekoslav Simiqin, Arsenije Vitosheviqin, Stanislav Leviqin, Radosav Mishiqin* dhe *Novica Krstiqin* për krime lufte kundër popullatës civile.

Sa i përket Kollashinacit, aktakuza pohon se së mes të korrikut 1998 dhe majit 1999 derisa vepronte si Kryetar i Kuvendit Komunal dhe Udhëheqës i Njësitit të Mbrojtjes Civile, ai (1) dështoi të pengonte aktet e kundërligjshme të vrasjeve, kidnapimeve, djegjeve dhe deportimeve të kryera nga ana e forcave ushtarake dhe policore; (2) muar pjesë në masakrat në tri fshatra; (3) bëri regjistrimin e civilëve me qëllim të kryerjes së deportimeve të shqiptarëve të Kosovës; (4) ishte përgjegjës për deportimet dhe shpërnguljet e civilëve; (5) organizoi kontigjentet e punës së detyrueshme të shqiptarëve të Kosovës; (6) ishte angazhuar në keqtrajtimin e një fshatari duke e rrahur atë dhe duke konfiskuar kamionin e tij; dhe (7) kishte kërkuar nga forcat ushtarake dhe policore Serbe

që të vijnë dhe t'i ndihmojnë në mbrojtjen e serbëve që jetonin në kuadër të komunitetit të tij, duke e ditur se forcat e kërkuara do të kryejnë vepra penale.

Sa i përket Jovanoviçit, aktakuza pohon se, derisa vepronte si anëtar i grupit paramilitar, ai (1) mori pjesë në masakrën e 62 civilëve më 25 mars 1999 (2) urdhëroi deportimin e civilëve e pastaj plaçkiti dhe djegi shtëpitë e tyre; dhe (3) kishte rrahur shqiptarët në autobus duke e vrarë edhe një fëmijë.

Gjashtë nga fillimisht tetë të pandehurit kanë ikur nga paraburgimi, duke e lënë vetëm Kollashinacin dhe Jovanoviçin që t'i nënshtrohen gjykimit. Gjykimi filloi më 2 maj 2001 para kolegjit të përbërë nga të gjithë gjykatës ndërkombëtar dhe para prokurorit ndërkombëtar. Kollashinaci paraqiti mbrojtjen duke u thirrur në prova të pamjaftueshme, mungesë të qëllimit për të kryer krime lufte dhe mungesë të pushtetit ligjor dhe faktik mbi forcat policore dhe ushtarake të cilat kryen krimet e pandehura të luftës. Jovanoviçi ngriti mbrojtjen nga alibia. Më 14 qershor 2001, kolegji e gjykoj Jovanoviçin sipas akuzës dhe e dënoi me 20 vjet burgim. Në të njëjtën datë, kolegji e gjykoj Kollashinacin për dhënjen e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale, dhe e dënoi me 5 vjet burgim.

Më 2 nëntor 2001, kolegji me shumicë ndërkombëtare i Gjykatës Supreme vërtetoi dënimin e Jovanoviçit, dhe ktheu aktgjykimin për shpalljen fajtor të Kollashinacit në rishqyrtim. Gjykata Supreme u pajtua me ankesën e prokurorit publik vendës se kolegji gjykues ka gabuar duke (1) vlerësuar gabimisht dëshminë mbi çështjet e punës së detyruar; (2) vlerësuar gabimisht provat përkitazi me “urdhërin që [i pandehuri] ka dhënë dhe/ose pranuar prej autoriteteve tjera ushtarake apo policore” mbi çështjen e plaçkitjes dhe shkatërrimit të pronës; dhe (3) vlerësuar gabimisht pasojat e dy regjistrimeve të inicuar nga i pandehuri, dhe vlerësimin të gabuar të lidhjes së tyre të mundshme me veprat penale.

Rigjykimi i Kollashinacit nuk ka filluar ende. Kollashinaci i mohon akuzat, dhe konsiderohet si i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij.

RADOVAN APOSTOLLOVIQ, BOZHUR BISHEVAC, MICKA KRAGOVIQ, BOGOLJUB JEVTIQ dhe LJUBISHA SIMIQ

Grupi etnik i të pandehurve: të gjithë serb të Kosovës
Gjykata: Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

Historia e rastit

Gjykimi

Data e aktakuzës: 8 shtator 2000

Akuza nga aktakuza: *Krime Lufte*, LP RFJ 142

Prokurori: fillimisht prokurori vendës i zëvendësuar nga prokurori ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtar
Aktakuza e parë e ndryshuar (kundër Radovan Apostolloviqit): *Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm me Djegje*, LPK 145 (një pikë); *Vjedhje e Rëndë* LPK 135 (një pikë)
Aktakuza e dytë e ndryshuar: (kundër Radovan Apostolloviqit)
Vjedhje e rëndë, LPK 135 (një pikë)
Aktgjykimi: I pandehuri Apostolloviq lirohet

Aktakuza e datës 8 shtator 2000 e ngarkon **Radovan Apostolloviqin, Bozhur Bishevacin, Micka Kragoviqin, Bogoljub Jevtiqin dhe Ljubisha Simiqin** me një pikë për krime lufte kundër popullatës civile. Aktakuza pohon se në mars dhe prill 1999, pesë të pandehurit, të gjithë të veshur në uniforma të ndryshme ushtarake, policore dhe paramilitare, kishin plaçkitur pronat e shqiptarëve të Kosovës të cilët u larguan mëpastaj prej frikës nga forcat ushtarake dhe policore serbe. Në mënyrë specifike, aktakuza pohonte se të pandehurit vjedhën një sasi të madhe të qirinjve, një ton patate, dy vetura, traktorë, një lopë, dhe gjëra të ndryshme personale nga depoja dhe shtëpitë, duke djegur mëpastaj shtëpitë e viktimave në fjalë.

Të pandehurit Bishevac, Kragoviq, Jevtiq, dhe Simiq ikën nga paraburgimi nga burgu i Mitrovicës pak para se prokurori vendës të paraqiste aktakuzën fillestare. Të katër këta të pandehur nuk janë gjykuar, qoftë në prani apo mungesë të tyre.

Gjykimi kundër të pandehurit Apostolloviq filloi më 10 prill 2001. Mbrojtja e Apostolloviqit ishte e bazuar në alibi. Më 13 korrik 2001 prokurori ndërkombëtar e ndryshoi aktakuzën, heqi dorë nga akuzat për krime lufte dhe në vend të saj pandehte kryerjen e veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm me djegje, dëmtimin e gjësëndit të huaj dhe vjedhje të rëndë. Më 28 janar 2002, prokurori ndërkombëtar sërish e ndryshoi aktakuzën, kësaj here duke pohuar se i pandehuri kishte kryer vetëm veprën penale vjedhje e rëndë. Të njëjtën ditë kolegji e shpalli Apostolloviqin të pafajshëm.

SAVA MATIQ

Grupi etnik i të pandehurit: serb i Kosovës
Gjykata: Gjykata e Qarkut në Prizren

Historia e rastit:

Gjykimi i parë

Data e aktakuzës: 11 shtator 2000
Akuza nga aktakuza: Krime lufte, LP RFJ 142
Prokurori: vendës
Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtar
Aktgjykimi: *Lëndime të lehta trupore*, LPK 39 (2)

Procedura ankimore gjyqësore:

Prokurori: vendës (prokurori nuk u paraqit në procedurën pranë Gjykatës Supreme)
Përbërja e kolegjit: të gjithë ndërkombëtarë

Vendimi: aktgjykimi për shpalljen fajtor kthehet në rishqyrtim

Rigjykimi:

Prokurori: vendës

Përbërja e kolegjit: të gjithë ndërkombëtar

Aktgjykimi: Lirohet

Aktakuza kundër **Sava Matiqit** pohonte se në mes të 23 marsit dhe 12 qershorit 1999, ai i është përmbajtur urdhërave të dhënë për sulmimin e popullatën e pambrojtur civile dhe kryerjen e veprave tjera (të paspecifikuara) penale të torturës, terrorit, marrjes së pengjeve, paraburgimit të kundërligjshëm, përfshirjes së personave të ndryshëm në punë të detyrueshme, shkatërrimit të pasurisë, dhe plaçkitjes. Më tej, aktakuza pohon se me 26 mars 1999 Matiqi iu nënshtrua urdhërave për të marrë pjesë në vrasjen e 42 civilëve të një fshati, dhe në rrahjet dhe keqtrajtimin fizik dhe psikologjik të personave nga fshati tjetër.

Gjykimi filloi me 22 janar 2001. Mbrojtja e Matiqit ishte e bazuar në alibi. Ai pranoi se kishte qenë i mobilizuar dhe i caktuar si roje në stacionin e autobusave, hotel dhe në rrugën kryesore gjatë bombardimeve të NATO-s, por mohoi të ketë ditur apo të ketë marrë pjesë në krimet e pandehura.

Më 29 janar 2001, kolegji gjykues e shpalli të pandehurin fajtor për lëndime të lehta trupore në lidhje me incidentin i cili ndodhi me 23 prill 1999 (ky incident nuk është përmendur në aktakuzë). Kolegji në mënyrë specifike gjeti se nuk kishte prova të mjaftueshme për të dënuar Matiqin për krime lufte siç ngarkohej me aktakuzë.

Si prokurori ashtu edhe mbrojtja u ankuan kundër aktgjykimit. Më 13 qershor 2001, Gjykata Supreme e refuzoi ankesën e mbrojtjes dhe aprovoi ankesën e prokurorit, duke e kthyer rastin për rigjykim sipas akuzës fillestare për krime lufte. Gjykata Supreme kishte dpër bazë dy argumente gjatë pruarjes së vendimi të tillë. Së pari, ajo gjeti se gjykata ka gabuar në gjykimin e të pandehurit për veprën e cila kishte elementa të ndryshme nga vepra e pandehur në aktakuzë. E dyta, Gjykata Supreme gjeti se gjykata kishte vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendjen faktike.

Rigjykimi filloi me 22 nëntor 2001. Matiqi mbështeti mbrojtjen e tij nga alibia. Më 27 mars 2002 kolegji, të gjithë gjykatës ndërkombëtar, e shpalli Matiqin të pafajshëm.

MOMQILLO TRAJKOVIQ

Grupi etnik i të pandehurit: serb i Kosovës

Gjykata: Gjykata e Qarkut në Gjilan

Historia e rastit:

Gjykimi i parë

Data e aktakuzës: 3 prill 2000

Akuza nga aktakuza: *Tentim vrasje*, LPK 30 dhe LP RFJ 19 (një pikë);
Armëmbajtje pa leje, LPK 199

Prokurori: vendës

Përbërja e kolegjit: shumica vendës

Akuzat e aktakuzës së dytë: *Krime lufte*, LP RFJ 142 (bashkanëgjitur
aktakuzës fillestare)

Aktgjykimi: Fajtor për *Krime kundër Njerëzimit* (sipas LP RFJ , 142);
Tentim Vrasje; Armëmbajtje pa leje

Procedura ankimore gjyqësore:

Prokurori: vendës, i zëvendësuar nga një ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtar

Vendimi: aktgjykimi mbi shpalljen fajtor kthehet në rishqyetim

Rigjykimi:

Prokurori: ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: shumica ndërkombëtar

Statusi i gjyqimit: në vazhdim e sipër

Aktakuza fillestare kundër Momqillo Trajkoviçit pandeh tentim vrasjen e ndodhur në incidentin e datës 27 qershor 1999, dhe posedimin kundërligjor të armëve që doli në dritë pas bastisjes së shtëpisë së të pandehurit më 7 shtator 1999. Aktakuza e dytë për krime lufte kundër popullatës civile, vë në pah se në 14 data të ndara në mes të prillit dhe majit 1999, derisa shërbente si shef i policisë në Kamenicë, Trajkoviçi i ka urdhëruar forcat policore nën komandën e tij që të kryejnë vepra të ndryshme penale të vrasjes, keqtrajtimit, zhvendosjes, marrjes së pengjeve, plaçkitjes dhe shtrëngimit. Aktakuza e dytë mëtej pohon se Trajkoviçi përpiloi listat e individëve të përfshirë në aktivitete politike, shoqërore dhe humanitare, dhe se ai i ka dhënë këto lista policisë me qëllim që këta individ të vriten.

Gjykimi i Trajkoviçit u zhvillua në mes të 23 nëntorit 2000 dhe 6 marsit 2001, para kolegjit me shumicë vendëse që përfshinte edhe një gjykatës ndërkombëtar. Trajkoviçi paraqiti mbrojtje të dyfishtë. Së pari, ai deklaroi se nuk kishte qenë prezent, e as nuk kishte urdhëruar, krimet e pandehura. E dyta, ai pohonte se pasiqë nuk ishte komandant i njësitit ushtarak, e as anëtar i ushtrisë, nuk mund të jetë penalisht i përgjegjshëm për kryerjen e krimeve të luftës përbrenda kuptimit të ligjit. Kolegji e shpalli të pandehurin fajtor për krime lufte, LP RFJ 142 (të cilin kryetari i kolegjit e paraqiti si vepër penale krime kundër njerëzimit që parashihet edhe me të drejtën ndërkombëtare zakonore), tentim vrasje, LPK 30 lidhur me LP RFJ 19, dhe armëmbajtje pa leje LPK 199. Dënimi i të pandehurit ishte 20 vjet burgim.

I pandehuri u ankua kundër këtij aktgjykimi; më 13 korrik 2001 prokurori publik i Kosovës u përgjegj duke parashtruar kërkesën pranë Gjykatës Supreme të Kosovës për të vërtetuar dënimin. Sidoqoftë, në një argumentim para kolegjit me shumicë ndërkombëtare të Gjykatës Supreme, prokurori ndërkombëtar pranoi se ishte bërë gabim dhe kërkoi që rasti të rikthehet për rigjykim. Gjykata Supreme edhe veprroi ashtu në vendimin e saj të dhënë më 30 nëntor 2001, duke bazuar këtë vendim në (1) mungesën e

provave për përgjegjësinë penale tre të pandehurit dhe (2) në dështimin e gjykatës për të ftuar dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja.

Rigjykimi filloi para kolegjit me shumicë ndërkombëtare më 27 maj 2002, dhe është në vazhdim e sipër. I pandehuri mohon akuzat dhe konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij.

BOGOLJUB MISIÇ dhe STOJAN JOVANOVIQ

Grupi etnik i të pandehurit Misiç:	serb i Kosovës
Grupi etnik i të pandehurit Jovanoviç:	serb i Kosovës
Gjykata:	Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

Historia e rastit:

Gjykimi

Data e aktakuzës:	1 shkurt 2001
Prokurori:	ndërkombëtar
Përbërja e kolegjit:	shumica ndërkombëtar
Aktakuza:	<i>Pjesëmarrja në grupin që ushtron dhunë, LPK 200(1); paraburgimi i paligjshëm, LPS 63(4); lëndime të rënda trupore, LPK 38(1)</i>
Aktgjykimi:	të dy të pandehurit të liruar nga të gjitha akuzat

Aktakuza kundër Bogoljub Misiçit dhe Stojan Jovanoviçit pohon se me 4 shtator 1998 të pandehurit ishin në mesin e një grupi me personel ushtarak dhe policor Serb, të cilët kishin hyrë në fshat dhe kshin shtyer me forcë tetëdhjetë e pesë meshkuj Shqiptarë të Kosovës që të hyjnë në një ahur. Në hyrje të ahurit, aktakuza pohon se serbët kanë rrahur shqiptarët dhe se, posaçërisht, Misiçi dhe Jovanoviçi, kanë rrahur Shqiptarët me gypa hidraulik të gomës. Brenda ahurit, serbët i shtyen me forcë këta persona që t'i dorëzonin gjërat e vlefshme që kishin në posedim.

Incidenti pohohet të ketë ndodhur në komunën e Prizrenit, por vendi i gjykimit është ndryshuar, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64, në Mitrovicë. Gjykimi filloi me 16 tetor 2001. Misiçi dhe Jovanoviçi paraqitën mbrojtjen nga alibia si dhe provat e pamjaftueshme identifikuese. Më 2 nëntor 2001 kolegji dorëzoi aktgjykimin në të cilin gjeti se kishte prova të mjaftueshme që vërtetonin se ngjarjet e përmendura në aktakuzë kishin ndodhur ashtu siç ishin përshkruar nga viktimat por nuk kishte prova të mjaftueshme për identifikimin e të pandehurve dhe pjesëmarrjen e tyre në krime. Andaj kolegji i liroi të dy të pandehurit.

ALEKSANDAR MLLADENOVIC¹⁰

Grupi etnik i të pandehurit: serb i Kosovës

¹⁰ Shqiptimi i emrit të të pandehurit me dy "l" është shkruar ashtu siç paraqitet në të gjitha dokumentet zyrtare gjyqësore në këtë rast.

Gjykata:

Gjykata e Qarkut në Prishtinë

Historia e rastit:

Gjykimi

Data e aktakuzës: 2 shkurt 2001

Akuza nga aktakuza: *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*, LPK 157(1) dhe (2) (tri akte të pandehura); *Dëmtimi i gjësendit të huaj*, LPK 145 (tri akte të pandehura); *Plaçkitje*, LPK 137 (dy akte të pandehura); *Vjedhje e rëndë*, LPK 135 (dy akte të pandehura)

Prokurori: ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: të gjithë ndërkombëtar

Aktakuza e parë e ndryshuar: *Krime lufte*, LP RFJ 142

Aktgjykimi: Lirohet (aktgjykimi me shkrim ende nuk është përpiluar nga gjykata)

Aktakuza fillestare kundër Aleksandar Mlladenoviqit pohon, përkitazi me shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm, se më 4 prill dhe 4 qershor 1999, i pandehuri, duke vepruar në kuadër të një grupi të përbërë nga personeli ushtarak, policor dhe paramilitar të uniformuar dhe të armatosur, ka djegur disa shtëpi të shqiptarëve të Kosovës, dhe se me 31 maj 1999 ai dhe të tjerët tentuan t'i vënë zjarrin një shtëpie. Sa i përket akuzave për plaçkitje, aktakuza pohon se me 4 dhe 22 prill 1999, i pandehuri me dhunë kishte marrë të holla nga tre shqiptarë. Në fund, sa i përket akuzave për vjedhje të rëndë, aktakuza thekson se më 24 mars dhe 5 qershor 1999, i pandehuri së bashku me të tjerët vodhën pasurinë personale nga një restorant dhe një shtëpi.

Gjykimi filloi me 14 qershor 2001, dhe disa javë më vonë, me 5 korrik 2001, prokurori ndërkombëtar (tjetër nga ai që kishte paraqitur aktakuzën fillestare) paraqiti aktakuzë të ndryshuar. Kjo aktakuzë e ndryshuar e ngarkonte Mlladenoviqin për krime lufte (aktet e pandehura që mbështesnin akuzat e krimeve të luftës ishin të njëjtat sikurse ato të theksuara në dokumentin fillestar akuzues). Mbrojtja e Mlladenoviqit ishte mohim i përgjithshëm.

Më 23 nëntor 2001 kolegji e liroi të pandehurin. Gjer më sot, kryetari ndërkombëtar i trupit gjykues ende nuk e ka përpiluar aktgjykimin me shkrim.

VESELIN BESHVIQ

Grupi etnik i të pandehurit: serb i Kosovës

Gjykata: Gjykata e Qarkut në Pejë

Historia e rastit:

Gjykimi

Data e aktakuzës: 11 nëntor 2001

Akuza nga aktakuza: *Krime lufte*, LP RFJ 142

Prokurori: ndërkombëtar

Përbërja e kolegjit: të gjithë ndërkombëtar
Statusi i gjykimit: në vazhdim e sipër

Aktakuza kundër *Veselin Beshoviqit* pohon se më 29 maj, 5 dhe 6 korrik, gusht, 8 tetor dhe 9 dhjetor 1998, dhe me 26 dhe 28 mars, 3 dhe 4 prill, dhe 14 maj 1999, Beshoviq ishte pjesëtar i forcave të armatosura dhe të uniformuara serbe të cilat përdorën kërcënimin dhe terrorin për të zhvendosur popullatën shqiptare nga shtëpitë e tyre dhe të cilët torturuan dhe vranë shqiptarët, djegën shtëpitë e tyre, dëmtuan dhe shkatërruan pronat e tyre, dhe në përgjithësi u shkaktuan vuajtje të mëdha civilëve shqiptar të Kosovës.

Gjykimi i Beshoviqit filloi në maj 2002, dhe është në zhvillim e sipër. I pandehuri mohon akuzat dhe konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij.

SASHA GRKOVIQ

Grupi etnik i të pandehurit: serb i Kosovës

Historia e rastit:

Gjykimi

Data e aktakuzës: 19 shkurt 2002

Akuza nga aktakuza: *Krime lufte*, LP RFJ 142

Statusi i gjykimit: gjykimi ende nuk ka filluar¹¹

Aktakuza kundër Sasha Grkoviqit pohon se më 25, 26, 27 dhe 28 mars 1999, Grkoviq, derisa ishte pjesëtar i personelit të uniformuar dhe armatosur serb, kishte marrë pjesë në shkatërrimin e shtëpive dhe pasurisë si dhe në zhvendosjen me dhunë të fshatarëve. Aktakuza më tutje pohon se Grkoviq si pjesëtar i grupit të armatosur dhe uniformuar Serb, kishte marrë pjesë edhe në tri masakra të ndara të një numri të madh të civilëve shqiptarë të Kosovës si dhe në vrasjen e një grupi prej katër meshkujve shqiptarë.

Sasha Grkoviq mohon akuzat e pandehura në aktakuzë, dhe konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij.

¹¹ Ky raport jep një pasqyrë mbi statusin e gjykimeve për krimet e luftës që janë zhvilluar që nga qershori 2002. Më 4 shtator 2002, Sasha Grkoviç ishte liruar nga të gjitha akuzat me vendim të trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Prizren.

PJESA III. LIGJI I APLIKUESHËM DHE AUTORITETET RELEVANTE

Kjo pjesë mëton të jetë një përmbledhje e legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë mbi krimet e luftës, e cila do të hedh vështrimin e saj si në dispozitat që kanë të bëjnë me substancën e rasteve gjegjëse ashtu edhe me mekanizmat procedural në dispozicion për ndjekjen dhe gjykimin e këtyre rasteve. Për më tepër, referimet do t'ju bëhen autoriteteve relevante që merren me krimet e luftës dhe të drejtën humanitare ndërkombëtare, pasi që këto autoritete janë treguar të jenë tejet të dobishme për rastet e ngjashme të cilat janë gjykuar qoftë sipas juridikcionit kombëtar apo atij ndërkombëtar.

I. LIGJI I APLIKUESHËM

Krimet substanciale

Tri veprat kryesore penale kundër të drejtës humanitare ndërkombëtare janë krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidi. Ky raport nuk ka për qëllim të paraqes një analizën komple të këtyre krimeve sipas të drejtës ndërkombëtare zakonore apo ligjeve të tribunaleve ndërkombëtare, por një njohuri themelore se çka ato në të vërtetë ngërthejnë në veti dhe do të ndihmoj për të vendosur ligjin e aplikueshëm kosovar në perspektivë të të gjithë kësaj.

Krimet e luftës mund të definoohen në mënyra të ndryshme në kuadër të juridikcioneve të ndryshme kombëtare apo ndërkombëtare; sidoqoftë, ato në thelb përbëjnë shkeljet e Konventave të Gjenevës, Protokoleve të saj apo ligjeve dhe zakoneve të luftës.¹²

Gjenocidi përfshin të gjitha aktet siç janë vrasjet apo shkaktimi i dëmit serioz trupor apo psiçik anëtarëve të një grupi kombëtar, etnik, racial, apo religjioz, të bërë me qëllim të shkatërrimit të grupit në tërësi apo pjesërisht.¹³

Krimet kundër njerëzimit përfshijnë aktet si vrasjen, asgjësimin, torturimin, apo persekutimin e kryer në mënyrë të gjërësishme dhe sistematike. Nuk ekziston kushti që krimet kundër njerëzimit të jenë të kryera në lidhje me konfliktin e armatosur.¹⁴

Në vështrim të ligjit të aplikueshëm në Kosovë, gjenocidi është i dënueshëm sipas LP RFJ 141. Komentuesi i këtij ligji ka theksuar se “bazat për caktimin e karakteristikave të gjenocidit janë dispozitat e [1948] Konventës për Pengimin dhe Dënimin e Krimit të

¹² Katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe Protokolet e saj të 8 qershorit 1977 ofrojnë një definicion të gjerë të krimeve të luftës nga perspektiva e të drejtës ndërkombëtare. Definicionet e ngjashme mundën gjithashtu të gjinden edhe në Statutin e GJNKL-së dhe GJNKR-së. Për definicionin e krimeve të luftës dhe legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë, shih Shtesën në këtë raport.

¹³ Për definicionin e gjenocidit sipas të drejtës ndërkombëtare, shih Konventën mbi pengimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit të datës 9 dhjetor 1948 (definicionet gjegjëse mund të gjinden në Statutin e GJNKL-së dhe GJNKR-së). Për definicionin e gjenocidit sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, shih Shtesën në këtë raport.

¹⁴ Elementet e krimeve kundër njerëzimit janë vendosur së voni nga GJNKL-ja në rastin *Prokurori kundër Krnojelacit*, IT-97-25, alinea 53; ajo gjithashtu është definuar në Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Neni 7.

Gjenocidit”¹⁵. Konventa të cilën Jugosllavia e ka ratifikuar më 1950¹⁶. LP RFJ 141 përcjell gjuhën e Konventës mbi Gjenocidin gati fjalë për fjalë, me, megjithate, një përjashtim kritik. “Zhvendosja e dhunshme e popullatës” e numëruar në LP RFJ 141 si mjet për kryerjen e gjenocidit, nuk është prezente në Konventën mbi Gjenocidin.

Nga tri nenet në Ligjin Penal të RFJ të cilat aplikohen për krimet e luftës kundër popullatës civile¹⁷, dy vepra, krimet e luftës kundër popullatës civile, LP RFJ 142¹⁸, dhe krimet e luftës kundër të plagosurve dhe të sëmurëve, LP RFJ 143¹⁹, paraqesin kodifikimet e neneve mbi Shkeljet e Rënda²⁰ të përmbajtura në Konventat e Gjenevës të vitit 1949. Komentuesi ka bërë vështrimin si të LP RFJ 142 dhe 143 si përcaktuese të përgjegjësisë penale për shkeljet e Konventave të Gjenevës 1949, ashtu edhe të Protokolleve Shtesë I dhe II të Konventave të Gjenevës.²¹ GJNKL, në vendimin e Tadiqit, gjithashtu ka cituar LP RFJ 142 dhe 143 si shembuj të legjislacionit kombëtar të dizajnuar për të implementuar Konventat e Gjenevës 1949.²² LP RFJ 142 dhe 143 ndalojnë si urdhërin ashtu edhe kryerjen e veprave penale të sipërpërmendura.

Neni i tretë mbi krimet e luftës që mund të aplikohet për viktimat civile është Organizimi i Grupit dhe Nxitja për Kryerjen e Gjenocidit dhe Krimeve të Luftës, LP RFJ 145. Ky neni i fundit, siç sugjeron komentuesi, ishte inspiruar si nga Konventa mbi Gjenocidin ashtu edhe nga Karta e Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak e vitit 1945 që themelon Tribunalin e Nyrnbergut për Krime Luftë (më tej Karta e Nyrnbergut).²³ LP RFJ përmban dispozitat nga Konventa për Gjenocidin përkitazi me nxitjen e gjenocidit²⁴, si dhe dispozitat nga Karta e Nyrnbergut që themelojnë përgjegjësinë për organizatorët dhe nxitësit e krimeve të luftës.²⁵ Sipas LP RFJ 145, “organizimi i grupit” për qëllime të kryerjes së gjenocidit dhe krimeve të luftës siç parashihet në LP RFJ 141-144, sikurse edhe anëtarësimi në një grup të tillë, është i dënueshëm.

Vepra penale e Përdorimit të Mjeteve të Ndaluar të Luftës, LP RFJ 148, i cili sikurse LP RFJ 141 DHE 142, aplikohet në kohë të luftës apo konfliktit të armatosur, ndalon përdorimin e “mjeteve apo praktikave të luftës të ndaluara nga rregullat e të drejtës ndërkombëtare”. Interpretimi logjik i “mjeteve apo praktikave të luftës të ndaluara nga

¹⁵ Franjo Bacic dhe tjerët, *Komentari i Ligjit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë*, Edicioni i 5-të, Beograd, 1999.

¹⁶ Gazeta Zyrtare e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Federale Nacionale të Jugosllavisë, nr. 2/50.

¹⁷ Neni i katërt, Krimet e Luftës Kundër të Burgosurve të Luftës, LP RFJ 144, nuk aplikohet për viktimat civile.

¹⁸ Parësisht e shpallur si neni 125 i Ligjit Penal të RFJ të v. 1951.

¹⁹ Parësisht e shpallur si neni 126 i Ligjit Penal të RFJ të v. 1951.

²⁰ Konventa e parë e Gjenevës Nenet 49 dhe 50; Konventa e dytë e Gjenevës, nenet 50 dhe 51; Konventa e Katërt e Gjenevës, nenet 146 dhe 147.

²¹ Franjo Baqiq dhe tjerët, më lart; *Prokurori kundër Tadiqit*, IT-94-1, Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ankesën Interlokutore për Kompetencë, 2 tetor 1995, paragrafi 132 (në tekstin e mëtejshëm Vendimi i Tadiqit)

²² Vendimi i Tadiqit, IT-94-1, paragrafi 132.

²³ *Franjo Baqiq dhe të tjerët*, më lart.

²⁴ Konventa mbi Gjenocidin Neni 3(c).

²⁵ Karta e Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak e vitit 1945, Neni 6.

rregullat e të drejtës ndërkombëtare” është shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës përbrenda kuptimit të Nenit 6 të Kartës së Nyrnbergut dhe Nenit 3 të Statutit të GJNKL.

Nuk ekziston ndonjë ekuivalent ligjor sipas ligjit penal të RFJ-së dhe atij të Kosovës për veprat penale të krimeve kundër njerëzimit që parashihen me të drejtën ndërkombëtare zakonore.

Dhe së fundi, në disa raste që ngërthejnë në veti veprimet e kryera në kontekst të luftës apo konfliktit të armatosur në Kosovë, prokurorët dhe gjykatat kanë aplikuar ligjet për veprat tradicionale penale të cilat nuk janë në mënyrë specifike të ndërlidhura me krimet e luftës apo shkeljet e të drejtës ndërkombëtare humanitare. Krimet “ordinere” me të cilat prokurorët akuzonin, ose të cilat gjykatat i kanë aplikuar, në këto raste përfshijnë vrasjen LPK 30; lëndimin e rëndë trupor LPK 39; pjesëmarrjen në grupin i cili ushtron dhunë, LPK 200; parburgimin e kundërligjshëm, LPS 63; shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm, LPK 157; dhe aktet e rënda kundër sigurisë së përgjithshme, LPK 164.

Ligji mbi përgjegjësinë penale

Ligji i aplikueshëm në Kosovë parasheh bazat për përgjegjësinë penale në mënyrë të ngjashme sikurse edhe sistemet juridike perendimore. Gjykatat mund të shpall personat e ndryshëm penalisht të përgjegjshëm për veprat individuale apo mosveprimet²⁶, aktet e përgatitjes²⁷, tentimet²⁸, bashkëveprimin²⁹, nxitjen³⁰, dhe ndihmën.³¹

Për më tepër, sipas LP RFJ 26, individët që formojnë apo përdorin forma të ndryshme të grupeve, bandave, apo bashkimeve për të kryer krime janë përgjegjës për të gjitha veprat penale të kryera nga grupet e tilla, pa marrë parasysh vëllimin e pjesëmarrjes së tyre. Komentuesit theksojnë se ky nen i vën në barrë përgjegjësinë penale organizatorit apo përdoruesit për të gjitha veprat penale të grupit.³² Kjo teori e përgjegjësisë i ngjan doktrinës së të drejtës penale ndërkombëtare mbi qëllimin e përbashkët apo organizatën e bashkuar për qëllime të kryerjes së veprave penale³³ e cila shpesh ishte vënë në theks gjatë gjykimeve për krime lufte në gjykatat ndërkombëtare.³⁴

²⁶ LP RFJ 11.

²⁷ LP RFJ 18.

²⁸ LP RFJ 19.

²⁹ LP RFJ 22.

³⁰ LP RFJ 23.

³¹ LP RFJ 24.

³² Ljubisha Llazareviq, komentari i LP RFJ 26, Administrata Bashkëkohore, Beograd, 1999; Franjo Baqiq, komentari i LP RFJ 26, Administrata Bashkëkohore, Beograd, 1978.

³³ GJNKL ka diskutuar doktrinën e qëllimit të përbashkët (apo organizatës së bashkuar për qëllime të kryerjes së veprës penale) gjerësisht në rastet vijuese: *Prokurori kundër Tadiqit*, GJNKL 94-1-A, Vendimi i Trupit Gjyqës të Apelacionit i 15 korrikut 1999, paragrafet 186-228 (mëtej Tadiq, Vendimi i Trupit Gjyqës të Apelacionit); *Prokurori kundër Brdaninit dhe Taliqit*, Vendimi mbi Formën e Aktakuzës së mëtejme të ndryshuar dhe Aplikacioni i Ndjekjes për Ndryshim, IT-99-36-PT, 26 qershor 2001, paragrafet 22-51.

³⁴ Tadiq, Vendimi i Trupit Gjyqës të Apelacionit, në paragrafet 230 dhe 231; *Prokurori kundër Kvockës dhe të tjerëve*, IT-98-30/1-T, Vendimi i Trupit Gjyqës të 2 nëntorit 2001, paragrafet 265-321 dhe 413-419; *Prokurori kundër Krstiqit*, IT-98-33, Vendimi i Trupit Gjyqës të 2 gushtit 2001, paragrafet 601 dhe 633.

Pasiqë rastet e krimeve të luftës shpeshherë përfshijnë organizatat e tipit ushtarak me struktura komanduese hierarkike, mjaft shpesh ngritet çështja se a mund të mbahet përgjegjës oficeri i nivelit të ultë për krimet të cilat ai apo ajo ka kryer sipas urdhërit nga oficeri i nivelit më të lartë. LP RFJ 239, Përgjegjësia për Veprat e Kryera Penale Sipas Urdhërave nga Lartë, i referohet kësaj situate, duke theksuar se personat që zbatojnë urdhërat nuk janë përgjegjës për krimet të cilat ata i kryejnë “në pajtim me urdhërat e eprorit më të lartë të dhëna në vijën e detyrës zyrtare, përveç kur ky urdhër ishte dhënë për kryerjen e krimeve të luftës apo ndonjë vepër tjetër të rëndë penale, apo nëse ishte mëse e dukshme se ekzekutimi i një urdhëri të tillë do të përbënte vepër penale.”³⁵

Situata e kundërt – përgjegjësia e zyrtarit të nivelit më të lartë i cili urdhëron kryerjen e krimeve të luftës – është mbuluar në vet formulimin e LP RFJ 142, i cili thekson se “Cilido...që urdhëron...apo kryen[një nga veprat e numëruara]” do të dënohet sipas ligjit. Megjithate, përgjegjësia e zyrtarit të lartë përfundon aty, sipas ligjit vendës; nuk ekziston ekuivalent ligjor nga doktrina e të drejtës ndërkombëtare për përgjegjësinë e eprorit më të lartë apo komanduesit³⁶, i cili vendos përgjegjësinë penale të zyrtarit të lartë për veprat penale apo mosveprimet e personave tjerë që zbatojnë urdhërat e tij.³⁷ Megjithatë, doktrina mbi përgjegjësinë penale të komanduesit mund të batohet në bazë të devotshmërisë së Jugosllavisë për të zbatuar dispozitat e Protokollit 1 të Konventës së Gjenevës. Nenet 86 dhe 87 të Protokollit 1 kodifikojnë parimet e përgjegjësisë penale të eprorit të lartë respektivisht përgjegjësisë së komanduesit ushtarak. Jugosllavia e kishte nxjerrë Ligjin mbi Ratifikimin e Protokolleve të Gjenevës³⁸ andaj, në pajtim me nenin 210 të Kushtetutës së RFJ-së të vitit 1974, këto Protokolle mund të zbatohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga gjykatat.

Ligji i procedurës

Rregullat e procedurës penale të parapara me Ligjin e Procedurës Penale të RFJ-së (LPP RFJ) zbatohen për ndjekjet penale për veprat penale krime të luftës sikurse për rastet e krimeve ordinere. Gjer në janar 2001, kjo përfshinte LP RFJ 300(3) dhe (4), të cilat lejonin mbajtjen e gjykimeve edhe në mungesë të të pandehurve (gjykimet në mungesë). Megjithatë, më 12 janar 2001, me nxjerrjen e rregullores së UNMIK-ut, ndalohet mbajtja e gjykimeve në mungesë për shkeljet e rënda të të drejtës humanitare ndërkombëtare.³⁹

³⁵ Kjo është qartë e drejtuar drejt argumenteve të prezentuara nga disa të pandehur për krime lufte se ata vetëm “kishin kryer urdhërat”.

³⁶ Përgjegjësia e komanduesit (e njohur gjithashtu edhe si përgjegjësia e superiorit) është definuar dhe është diskutuar gjërësisht në rastin e GJNKL *Prokurori kundër Delalijit* dhe të tjerëve, IT- 96-21, Vendimi i Trupit Gjykoës të 16 nëntorit 1998, paragrafet 331-399.

³⁷ Për vështrim të mëtejshëm në teorinë e përgjegjësisë së superiorit apo komanduesit, shiko Seksionin IV të këtij raporti.

³⁸ Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, Ligji mbi Ratifikimin e Protokolleve të Gjenevës, Marrveshja Ndërkombëtare, 1083, 26 dhjetor 1978.

³⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/1, Mbi Ndalimin e Gjykimeve në Mungesë për Shkelje Serioze të të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare.

Një aspekt relevant për mënyrën e hetimeve dhe gjykimeve të rasteve të krimeve të luftës në Kosovë ishte transformimi dhe evoluimi i kornizës ligjore. Mekanizmat procedural të cilat nuk ishin në dispozicion gjatë përpjekjeve fillestare të gjyqësisë vendëse për të gjykuar rastet e krimeve të luftës më vonë ishin vënë në dispozicion përmes rregulloreve të ndryshme të UNMIK-ut.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/20 mbi mbrojtjen e palës së dëmtuar dhe dëshmitarëve në Procedurën Penale, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/21 mbi dëshmitarët bashkëpunues, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/7 mbi përdorimin e procesverbaleve të shkruara të intervistave të zhvilluara nga organet për zbatimin e ligjit, kanë mbushur zbrazëtirat që ekzistonin në kuadër të ligjit të zbatueshëm në fushat të cilat janë më të rëndësishme me qëllim të zhvillimit të sukseshëm të hetimeve dhe ndjekjes penale: mbrojtja e dëshmitarëve dhe palëve të dëmtuara, përdorimi i deklaratave të dhëna para organeve për zbatimin e ligjit etj.

II. AUTORITETET MBI KRIMET E LUFTËS DHE TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE HUMANITARE

Burimet për të pasur autoritete bindëse ligjore mbi krimet e luftës dhe gjenocidin janë të pakta. Ekzistojnë disa komente mbi Ligjin Penal të RFJ-së të cilat ofrojnë analiza të shkurta mbi krimet e luftës dhe ligjeve mbi gjenocidin.⁴⁰ Franjo Baqiq në komentin e tij mbi LP të RFJ-së neni 142 citon vendimet që datojnë nga 1950 nga Gjykata Supreme e Kroacisë, Gjykata Supreme e Bosnës dhe Hercegovinës dhe Gjykata Supreme e Serbisë⁴¹, por ushtruesit e praktikës nuk kanë qasje të gatshme në kopjet e këtyre vendimeve. Andaj, në nivel të autoriteteve dhe jurisprudencës ligjore vendëse, udhëzimet për interpretimin dhe aplikimin e ligjeve të krimeve të luftës është jashtëzakonisht e kufizuar.

Megjithatë, për ata praktikantë të cilët e njohin gjuhën angleze, begatia e jurisprudencës, analizat, dhe komentaret përkitazi me krimet e luftës dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare janë vënë në dispozicion nga shumë organe ndërkombëtare të drejtësisë dhe tribunalet e ndryshme. Të njëfarë gjysëm rëndësie janë gjithashtu edhe aktgjykimet e Tribunaleve të themeluara pas Luftës së Dytë Botërore, të Nyrnbergut dhe Tokios. Së voni, GJNKL dhe GJNKR kanë marrë vendime të cilat, duke interpretuar dhe aplikuar ligjet e tyre gjegjëse, ofrojnë sqarime të vlefshme dhe vështrim për juristët që kërkojnë udhëzime në zbatimin e legjislacionit vendës për krime të luftës. Si plotësim, komentaret e Komisionit për të Drejtën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara përkitazi me *Projektin e Ligjit të Krimeve Kundër Paqës dhe Sigurisë së Njerëzimit, 1996*, mund të shërbejnë si autoritete bindëse në interpretimin e legjislacionit për krimet e luftës.

⁴⁰ Shih, për shembull, Franjo Baqiq dhe të tjerët, mëlartë.

⁴¹ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kroacisë numër KZ – 2787/57; aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Bosnës dhe Hercegovinës numër KZ-663-53; aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Serbisë numër KZ – 2539/56 (të gjitha të cituara nga Franjo Baqiq, mëlartë)

Për më tepër, një numër i gjykatave vendëse, në dy dekadat e kaluara, kanë adresuar çështjet e krimeve të luftës në një sërë kontekstesh të ndryshme. Gjermania,⁴² Franca,⁴³ Shtetet e Bashkuara,⁴⁴ Danimarka,⁴⁵ dhe Holanda⁴⁶ janë disa nga shtetet, gjykatat e të cilave kanë marrë vendime përkitazi me krimet e luftës dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare. Jo të gjitha nga këto raste janë vënë dispozicion në gjuhën angleze; sidoqoftë, prezenca e gjykatësve ndërkombëtar në Kosovë me një llojllojshmëri gjuhësh krijon mundësi për shpërndarjen e parimeve të gjetura në atë jurisprudencë.

⁴² Gjykata Supreme e Diseldorfit, rasti i *Nikola Jorgiqit*, 30 prill 1999, 3 StR 215/98; Gjykata Bavariene e Apelacionit, rasti i *Novislav Gjajiq*, 23 maj 1997, 3 St 20/96.

⁴³ Klaus Barbie, Raportet e të Drejtës Ndërkombëtare 78, vëll. 78 (1985).

⁴⁴ *Sh. B. kundër. Karaxhiqit* 70 F.3 d 232 (2d Cir. 1995).

⁴⁵ *Prokuroria kundër. Sariqit*, e pa publikuar (Den.H. Ct. 1994)

⁴⁶ *Prokurori publik kundër. Menten*, 75 Raportet e të Drejtës Ndërkombëtare, 1987.

PJESA IV. ANALIZA E RASTEVE

I. AKUZIMI

Krimet substanciale

Si tej-akuzimi ashtu edhe nën-akuzimi kanë karakterizuar ndjekjet për krimet e luftës në katërmbëdhjetë muajt e parë të administrimit gjyqësor të UNMIK-ut. Nëntë aktakuza dhe dy kërkesa për hetime të parashtruara nga prokurorët vendës reflektojnë vështirësitë që ata kanë pasur në analizimin e saktë të provave të disponueshme dhe të pranueshme dhe në marrjen e vendimit se me cilat akuza penale të vazhdojnë në procedurë. Krahasimi i raportimeve faktike në aktakuza me krimet me të cilat ngarkohet demonstroi se prokurorët vendës shpesh nuk i kuptojnë qartë elementet e veprave penale të cilat i paraqesin, e as nuk vlerësojnë efektivisht se si provat që i kanë në dispozicion mund të mbështesin elementet e krimit.

Prokurorët vendës kanë ngritur aktakuzën për gjenocid në katër raste-Vuqkoviq/Bishevac, i mituri Z, Jokiçi dhe Simiqi dhe të tjerët- gjatë vitit të parë të administrimit gjyqësor të UNMIK-ut. (Në rastin e pestë, të Kostiqit, raportimet mbi gjenocidin ishin baza për hetime gjyqësore të cilat nuk rezultuan me aktakuzë). Asnjëri nga të katër rastet nuk rezultoi në shpalljen fajtor të këtyre personave për gjenocid. Ndonëse trupi gjykues fillimisht e kishte shpallur fajtor Vuqkoviqin për gjenocid, trupi gjykues i përbërë nga shumica e gjykatësve ndërkombëtarë i Gjykatës Supreme e ktheu këtë vendim në rishqyrtim me arsyetim se nuk kishte mbështetje nga faktet. Në rastin e Jokiçit, ndonëse prokurori e parashtroi rastin para trupit gjykues mbi akuzat për gjenocid, kolegji parashtroi aktgjykimin për krime lufte.⁴⁷ Prokurori ndërkombëtar i caktuar për rastin e të miturit Z e ndryshoi akuzën për gjenocid në Shkaktim të Rrezikut të Përgjithshëm dhe Akte të Rënda kundër Sigurisë së Përgjithshme. Përfundimisht, në rastin e Igor Simiqit, prokurori ndërkombëtar përfundimisht heqi dorë nga ndjekja penale për gjenocid për shkak të mungesës së provave.

Në të gjitha këto katër raste, akuzat fillestare për gjenocid ishin, në dritë të provave gjyqësore, të tepruara, të pa bazuara në konsiderata ligjore dhe analiza solide. Dokumentet akuzuese në të gjitha rastet, sikurse dhe provat e prezentuara në gjykatë, nuk kanë adresuar në mënyrë të duhur çështjen e qëllimit të të pandehurit për të kryer veprën penale të gjenocidit. Për më tepër, edhe kur ndjekja ishte e aftë për të treguar se i pandehuri kishte qëllimin e kërkuar për “të shkatërruar plotësisht apo pjesërisht grupin”, kjo prapë nuk do të ishte e mjaftueshme që në mënyrë reale të argumentohet dhe vërtetohet rasti i gjenocidit. Siç shprehet GjNKL në rastin Jelishiq, “do të ishte shumë vështirë në praktikë të ofrohen prova të qëllimit të gjenocidit që e ka një individ nëse krimet e kryera nuk janë gjithëpërfshirëse dhe nëse krimi i akuzuar nuk mbështetet nga ndonjë organizatë ose sistem”.⁴⁸ Kjo do të thotë se kërkohen provat e mëtutjeshme për të

⁴⁷ Gjykata Supreme më vonë e prishi vendimin për krime lufte; aktgjykimi nuk e diskuton çështjen se a mundet gjykata, sua sponte, të dënoi të pandehurin për krime lufte, LP RFJ 142 kur aktakuza pandeh Gjenocid, LP RFJ 141.

⁴⁸ *Prokurori kundër Jelishiqit*, IT-95-10, Trupi Gjykues I, Vendimi, 14 dhjetor 1999, paragrafi 101.

vërtetuar se ka ekzistuar një operacion sistematik dhe i organizuar, në të cilin ka marrë pjesë edhe i pandehuri. Provat e tilla mund të mbledhen dhe mbështeten vetëm nga një punë e madhe studiuuese dhe analizat e nxjerra nga perspektivat e ndryshme historike, ligjore dhe sociologjike, asnjëra nga të cilat nuk është bërë dhe nuk kanë qenë në dispozicion në kohën kur gjykatat e Kosovës kanë ngritur akuzat për gjenocid. Duke pasur parasysh se gjenocidi është njëra ndër veprat më të rënda dhe më të ndërlikuara penale sipas të drejtës ndërkombëtare, ndjekja e saj kërkon burime të mëdha logjistike dhe njerëzore, të cilat madje edhe në momentin e tanishëm, gjykatat vendëse nuk i kanë tërësisht në dispozicion.

Shembull tjetër i tej-akuzimit u paraqit edhe në rastin e Apostolloviqit dhe të tjerëve, në të cilin prokurori vendës akuzoi të pandehurin për krime të luftës sipas LP RFJ 142. Në gjykim, nuk u paraqitën prova të mjaftueshme dhe të besueshme që do të vërtetonin si kryerjen e veprës penale gjithashtu edhe të kryesve të tij për të mbështetur atë akuzë. Prokurori ndërkombëtar (i cili zëvendësoi prokurorin vendës me qëllim që të merrej me rastin në gjykim) kishte hequr dorë nga pika fillestare e përfshirë në aktakuzë, dhe në fund të gjykimit, aktakuza e ndryshuar përmbante vetëm vjedhjen e rëndë (për të cilën i pandehuri ishte liruar).

Në aspektin paradoksal, nën-akuzimi i rasteve gjithashtu paraqiste problem. Prokurorët vendës, në të katër rastet i ngarkuan të pandehurit me vrasje të kryera në situatat faktike që mbështesnin aktakuzat e ngritura për krime më të rënda. Shkaku kryesor për nën-akuzimin e këtyre rasteve duket të kishte qenë mënyra në të cilën ekzistimi i konfliktit të armatosur në Kosovë ishte interpretuar nga prokuroria dhe gjykatat.

Në përgjithësi, ishte e njohur se periudha e fushatës së bombardimeve të NATO-s në Kosovë, nga Marsi 1999 gjer në qershor 1999, ishte periudha e konfliktit të armatosur dhe, andaj, krimet dhe shkeljet e të drejtës ndërkombëtare humanitare në këtë periudhë nuk duhet të imponojnë ndonjë vështirësi gjatë karakterizimit si krime lufte. Periudha para fushatës së NATO-s, posaçërisht koha nga fillimi i marsit 1998 dhe gjatë tërë dimrit 1999, kishte qenë interpretuar në mënyrë jo të qëndrueshme nga akterë të ndryshëm. Prokurorët të cilët parashtruan aktakuzat fillestare në rastet e krimeve të luftës në Kosovë ishin kundër definimit të periudhës mars 1998-mars 1999 si periudhë e konfliktit të armatosur, ndonëse dokumentet e numërta zyrtare dhe publike mbështesnin teorinë e konfliktit të armatosur. Një seri raportesh dhe rezolutash të Këshillit të Sigurimit të KB-së, të lëshuara duke filluar që nga pranvera e vitit 1998, përmendin situatën e konfliktit dhe të krizës humanitare në Kosovë, dhe madje e karakterizojnë atë shprehimisht si konflikt i armatosur.⁴⁹ Përgjatë vijave të njëjta të argumentimit, raporti special i përpiluar në dy vëllime nga OSBE-ja “Kosova siç është parë, siç është thënë” flet mbi periudhën e vitit 1998 si periudhë të konfliktit të armatosur dhe shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare.⁵⁰

⁴⁹ RKS KB 1199/23 shtator 1998, RKS KB 1160/31 mars 1998, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm i përgatitur në pajtim me Rezolutën 1160 (1998) të Këshillit të Sigurimit të lëshuar më 4 Shtator 1998, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm i përgatitur në pajtim me Rezolutën 1160 (1998) të Këshillit të Sigurimit të lëshuar më 3 tetor 1998.

⁵⁰ Shih më tutje, “Kosovo/Kosova siç është parë, siç është thënë”, Pjesa e I-rë, mund të gjindet në Websajtin e OSBE –së në adresën: www.osce.org/kosovo/documents/reports/hr.

Sidoqoftë, konfuzioni i shkaktuar në lidhje me natyrën e situatës që ekzistonte në Kosovë gjatë vitit 1998 dhe 1999 na shpie drejt akuzave jo të duhura me të cilën ngarkohen të akuzuarit në disa raste të krimeve të luftës të analizuar në këtë raport.

Prokurori ndërkombëtar vazhdoi me ndjekjen penale që ngarkonte të akuzuarit për disa krime “ordinare” (shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, dëmtimi i sendit të huaj, plaçkitje dhe vjedhje) të cilat ndodhën në kontekstin faktik që mbështeste akuzat për krime lufte, pasi që krimet e raportuara ndodhën në kontekst të konfliktit të armatosur në prill, maj dhe fillim të qershorit 1999.

Veprat penale në dy prej katër rasteve të vrasjes, Zvezdan Simiq dhe Zoran Stanojeviq, ndodhën gjatë periudhës së hershme të konfliktit të armatosur, i cili ekzistonte në mes të UÇK-së dhe forcave Serbe gjatë tërë vitit 1998 dhe dimrit të 1999-tës. Në të dyja këto raste, prokuroria pohonte se të pandehurit, derisa vepronin si pjesëtar të forcave të uniformuara dhe të armatosura policore dhe ushtarake serbe, kishin kryer vepra penale të vrasjes, djegjes së shtëpive, dhe zhvendosjes së personave. Për dallim nga kjo, aktakuzat e për këto raste të cilat jemi duke i shqyrtuar, janë ngritur nga një prokuror ndërkombëtar – në mënyrë specifike ngarkojnë të pandehurit⁵¹ për krime lufte, LP RFJ 142, për veprimet e kryera në periudhën maj - dhjetor 1998.

Dy rastet e mbetura, në të cilat prokurorët vendës ngarkojnë personat në fjalë për vrasje, e jo për krime lufte, janë Ajeti/Stojanoviq dhe Nikolliq. Krimet me të cilat ngarkohen këta persona burojnë nga incidentet që ngjanë gjatë muajit prill 1999. Në të dy rastet, të pandehurit, raportohet të kenë vepruar si pjesëtar të një grupi të uniformuar dhe të armatosur ushtarak, policor dhe paramilitar, të cilët kishin marrë pjesë në shpërnguljen e civilëve nga shtëpitë e tyre dhe kishin kryer edhe vepra penale të vrasjes. Të dyja këto raste të ndjekjes penale udhëhiqeshin nga një prokuror ndërkombëtar pasi që Gjykata Supremme ktheu rastet në rishqyrtim pas ankesës (mbi baza që nuk kanë të bëjnë me akuzat). Sidoqoftë, në asnjërin rast prokurori ndërkombëtar nuk e ndryshoi aktakuzën për të akuzuar për krime lufte në vend se për vrasje.

Aktakuza fillestare në rastin Mlladenoviq tregon se problemi i nën-akuzimit nuk ishte i kufizuar vetëm te prokurorët vendës. Këtu, prokurori i parë ndërkombëtar që muar rastin akuzoi vetëm për krimet “ordinare” – shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, dëmtimi i sendit të huaj, plaçkitje dhe vjedhje të rëndë – edhe pse veprat penale ndodhën gjatë periudhës së mirënjohur të konfliktit të armatosur në Kosovë (prill, maj dhe fillimi i qershorit 1999), dhe edhe pse ishte raportuar se i pandehuri kishte vepruar bashkë me forcat serbe. Megjithate, deri në kohën para fillimit të gjykimit, prokurori i ri ndërkombëtar kishte marrë përsipër ndjekjen penale të rastit dhe kishte ngritur një aktakuzë të re të ndryshuar dhe të strukturuar mirë që i ngarkon personat në fjalë për krime të luftës, bazuar në fakte të njëjta siç pohohen në kuadër të tekstit të aktakuzës së parë.

⁵¹ Veselin Beshoviq.

Organizimi dhe përpilimi i aktakuzave

Pasiqë aktakuza paraqet një instrument ligjor që i bën me dije të akuzuarit për akuzat kundër tij apo saj, dha bazat faktike për këto akuza, ajo duhet të jetë e përpiluara në mënyrë të qartë dhe specifike. Aktakuza e organizuar mirë dhe specifike jo vetëm që i mundëson të akuzuarit të përgatis mbrojtjen e tij apo të saj në mënyrë më efektive, por gjithashtu ajo luan një rol vendimtare nëse dëshirojmë të kemi një ndjekje penale të suksesshme. Rëndësia e aktakuzës së strukturuar qartë është veçanërisht e rëndësishme në rastet e ndërlikuara ku pohohet për një sërë viktimash të ndryshme dhe për veprat penale të kryera gjatë një periudhe të caktuar kohore, siç është rasti edhe me shumë raste të ndjekjes penale për krime të luftës.

Akuzat për gjenocid dhe krime të luftës burojnë mjaft shpesh nga një numër i veprave penale të veçanta. Nuk është as e domosdoshme e as e zakonshme të akuzosh dikë për një pikë të ndarë të aktakuzës që ka të bëjë me krimet e luftës, për shembull, për secilën vepër individuale të paligjshme të kryer nga i pandehuri gjatë periudhës së konfliktit të armatosur. Megjithatë, për qëllime të bërjes me dije të të pandehurit, dhe për sigurimin e gjykatës me kornizë se si do të procedojë prokuroria, aktakuzat duhet të jenë të strukturuar dhe organizuara në mënyrë të qartë përkitazi me datat, viktimat dhe identifikimin e pasurisë dhe vendeve.

Prokurorët vendës ngritën 13 prej 17 aktakuzave të shqyrtuara në këtë raport. Ndonëse disa nga aktakuzat e prokurorëve vendës në mënyrë të kënaqshme specifikonin datat, detajet, dhe viktimat e veprave penale të pohuara, aktakuzat tjera, posaqërisht këto që përfshijnë vepra penale të shumta dhe viktimat të shumëfishta, ishin të dobëta dhe tepër të gjera. Për shembull, në rastin e aktakuzës së Vuqkoviqit, prokurori vendës pohonte kryerjen e veprave penale të ndryshme pa i përmendur datat në të cilat këto vepra ishin kryer (përveq “nga fundi i marsit deri në maj 1999”). Në rastin e Matiçiqit, paragrafi fillestar i aktakuzës ishte aq gjerësisht i formuluar saqë do të kishte qenë e pamundur që t’i bëhet me dije të akuzuarit se për çka duhet të mbrohet. Dhe në rastin e të miturit Z, Propozimi për Masat e Sigurisë, (në rastet e të miturve, është i njëjtë sikur aktakuza), sërish pohohet vetëm për një kohë e përgjithësuar (“nga fundi i marsit deri në maj 1999”) dhe në këtë propozim nuk janë të përfshira deklaratat e besueshme që mbështesin faktet.

Prokurorët ndërkombëtar, në fazën e dytë të gjykimeve për krime lufte, ishin caktuar për t’u marrë me kontestimin e aktakuzave tashmë të ngritura nga prokurorët vendës. Megjithatë, pasi që prezenca e prokurorëve ndërkombëtar ishte institucionalizuar dhe ata filluan të kërkojnë fillimin e hetimeve dhe të përpilojnë vetë aktakuzat e para, kualiteti i shkresave u përmirësua. Në rastet e Grkoviçiqit dhe Beshoviçiqit, për shembull, aktakuzat pasqyrojnë një qasje të qartë, të organizuar dhe sistematike të cilat shërbejnë si shembuj se si duhet parashtruar një seri raportimesh faktike me qëllim që të pandehurin të informimit të plotë të të pandehurit mbi akuzat me të cilat ngarkohet. Dy aktakuzat të cilat ishin ngritur nga prokurori ndërkombëtar, në rastet e Mlladenoviçiqit dhe Beshoviçiqit, gjithashtu janë të veçanta, për atë se në mënyrë specifike raportojnë për elementin thelbësor të LP RFJ-së neni 142: “rregullat e të drejtës ndërkombëtare” të shkelura nga i pandehuri (në këtë rast, Konventa e Parë e Gjenevës dhe Protokoli Shtesë I).

II. AFTËSIA E MBROJTJES PËR TË PARAQITUR PROVAT

Gjatë dy viteve të para kur kanë filluar të hetohen dhe ndjeken penalisht rastet e krimeve të luftës, nuk ishin bërë përpjekje serioze nga ana e gjykatave vendëse apo nga DAD-i për të ndihmuar të pandehurit në marrjen e dëshmimeve nga dëshmitarët Serb të mbrojtjes. Nga shtatë rastet e kthyer në rishqyrtim pas parashtrimit të ankesës pranë Gjykatës Supreme, pesë nga këto vendime për kthim në rishqyrtim ishin si rezultat i dështimeve të gjykatës për të thirrur dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja.⁵²

Ky refuzim i bërë nga një pjesë e gjykatësve vendës për të thirrur dëshmitarët e mbrojtjes mund të ishte edhe si rezultat i mungesës së trajnimit dhe ekspertizës përkitazi me legjislacionin e zbatueshëm për të drejtat e njeriut.⁵³

Sidoqoftë, këtu përfshiheshin edhe çështjet e ndryshme të sigurisë së duhej arranzhuar me qëllim të paraqitjes së dëshmitarëve serb në gjyq gjatë proceseve gjyqësore për krime të luftës, çështje këto që nuk mund të zgjidheshin nga vetë gjykatat pa një ndihmë më të gjerë logjistike. Për shembull, dëshmitarëve të cilët jetojnë në teritorin e Serbisë dhe të cilët dëshirojnë të vijnë në Kosovë për të dëshmuar do t'ju nevojitet transportimi i sigurtë i tyre deri në dhe nga gjykatat e Kosovës. Opcioni tjetër, ai i mbajtjes së seancave gjyqësore në teritorin e Serbisë, gjithashtu kërkon mbështetje dhe koordinim nga DAD/DD.

Trupat gjykues të përbërë nga gjykatës ndërkombëtar të Gjykatës Supreme kanë bazuar tri vendime të tyre për kthim të rastit në rishqyrtim në dështimet e gjykatave të instancës më të ulët për të thirrur dëshmitarët e mbrojtjes dhe për këtë arsye DAD-i morri edhe veprime konkrete.⁵⁴ Që nga qershori 2001, kolegjet ndërkombëtare që merreshin me rastet e krimeve të luftës kishin ndërmarrë hapat e duhur për t'ju lejuar avokatëve mbrojtës që plotësisht të paraqesin mbrojtjen e tyre. Kjo ndonjëherë ka nënkuptuar që trupat gjykues të udhëtojnë madje edhe për në Beograd me qëllim të marrjes së deklaratave nga dëshmitarët.

III. AKTGJYKIMET E GJYKATAVE

Pesë veçori janë të përbashkëta për shumicën e aktgjykimeve për krime të luftës: (1) vënia e theksit në çështjet e besueshmërisë së dëshmitarëve; (2) mungesa e rezultateve të

⁵² Shih tabelën “Vendimet e Gjykatës Supreme”, më poshtë në faqen 46.

⁵³ Sipas KEDNJ-së Nenit 6(3), i akuzuari ka të drejtë “për të ekzaminuar apo të ketë ekzaminuar dëshmitarët kundër tij apo për të marrë pjesë në ekzaminimin e dëshmitarëve, nën të njëjtat kushte sikurse dëshmitarët kundër tij”. Kjo nuk i jep mbrojtjes të drejtën absolute për të marrë në pyetje cilindo dëshmitarë që dëshiron për të thirrur; gjykatat vendëse mund të vlerësojnë dëshmitë e propozuara dhe të refuzojnë të thirrur dëshmitarët të cilët nuk janë të rëndësishëm për çështjen e cila gjykohet. *Vidal kundër Belgjikës*, vendimi i GJEDNJ-së të 22 prillit 1992, Seria A, nr. 235-B, paragrafi 33, *Kremrovskij kundër Lituanisë*, GJEDNJ-së, aplikimi nr. 37193/97, Vendimi për praninë të 20 prillit 1999. Sidoqoftë, dështimi për të thirrur dëshmitarët, dëshmia e të cilëve do të ndikojë në teorinë e mbrojtjes së të pandehurit - sikurse në rastin me dëshmitarët e alibisë - nuk është në pajtim me konceptin e gjykimit të drejtë në të cilin bazohet edhe neni 6 i KEDNJ-së. *Vidal* në paragrafin 34.

⁵⁴ Nikoliq, Vučković, dhe Jokić.

duhura përkitazi me natyrën e përgjegjesisë penale të të pandehurit; (3) dështimi për të bërë dallimin në mes të çështjeve faktike dhe atyre ligjore; (4) mungesa e citimeve nga praktika ligjore apo mbizotërimi i jurisprudencës mbi krimet e luftës apo të drejtat e njeriut; dhe, (5) dhënien e përfundimeve të pasakta mbi veprat më të buta apo veprat tjera.

Tabela e mëposhtme ofron statistika përkitazi me disponueshmërinë e aktgjyqimeve me shkrim të cilat ishin bazë për kryerjen e analizave të paraqitura si në vijim.

<u>Aktgjykimet dhe vendimet me shkrim për Krimet e Luftës</u>				
	Kolegjet vendëse	Kolegjet vendëse të Gjykatës Supreme	Kolegjet ndërkombëtare	Kolegjet ndërkombëtare të Gjykatës Supreme
Numri i aktgjyqimeve/ vendimeve të dhëna me shkrim	7	1	10	9

Çështjet e besueshmërisë

Kolegjet gjyquese të gjykatave kanë përqëndruar vëmendjen e tyre më së shumti në aktgjykimet me shkrim përkitazi me çështjet e besueshmërisë së dëshmitarëve. Ligji i aplikueshëm për aktgjykimet me shkrim, LPP RFJ 357(7) parasheh që aktgjykimi i shkruar duhet “në mënyrë specifike dhe të plotë të deklaroj se në bazë të cilave fakte dhe mbi çfarë bazash gjen se ato janë të provuara apo të pa provuara, duke ofruar në mënyrë specifike një vlerësim mbi besueshmërinë e provave kundërthënëse...”

Pra, theksimi i gjykatave për çështjet e besueshmërisë është bazuar pjesërisht në këtë kërkesë ligjore.

Si plotësim, shumica e personave të akuzuar kanë paraqitur mbrojtjen bazuar në alibi dhe mosidentifikim, dhe disa gjykime përfshijnë prezentimet e provave të rëndësishme materiale, fotografike, apo dokumentare që mund të mbështesin apo dobësojnë verzionet e ngjarjeve nga ana e dëshmitarëve. Mbrojtësit e të pandehurve nuk kanë paraqitur mbrojtjen ligjore si mbrojtje të nevojshme⁵⁵, apo nevojë ekstreme⁵⁶. Shkurt, pasiqë çështja esenciale në shumicën e gjykimeve për krime të luftës ishte se a kishte qenë i pandehuri në vendin e ngjarjes, saktësia e supozuar e tregimit të ngjarjeve nga dëshmitari apo identifikimi, ishte e një rëndësie të veçantë për të vendosur mbi qështjen e fajësisë apo pafajësisë.

⁵⁵ LP RFJ 9.

⁵⁶ LP RFJ 10.

Kriteret për vlerësimin e besueshmërisë

Gjer më tani, të gjitha apo shumica e kolegjeve gjyquese ndërkombëtare kanë dhënë pesë aktgjykime me shkrim⁵⁷ lidhur me rastet e krimeve të luftës; në dy raste⁵⁸ me kolegje prej shumicës vendëse, ndërsa gjykatësi ndërkombëtar ka qenë autor i aktgjykimit.⁵⁹ Analiza e dëshmimeve të dëshmitarëve të cilat gjykatësit ndërkombëtar prezantojnë në këto aktgjykime të shkruara, theksojnë rëndësinë të cilën ata ia kushtojnë besueshmërisë për të vendosur nëse individit dëshmon të vërtetën dhe saktë. Aktgjykimet shpeshherë janë tejet të hollësishme lidhur me deklaratën e secilit dëshmitar dhe si është ajo konsistente apo dallon nga deklaratat e dhëna në polici apo para autoriteteve të KFOR-it, para gjykatësve hetues apo gjatë gjykimeve të mëparshme. Shumë kolegje gjyquese ndërkombëtare kanë konsideruar (vlerësuar) se dëshmitarët e prokurorisë, të cilët kanë dhënë deklarata jokonsistente, janë të pabesueshëm dhe nuk tregojnë të vërtetën.

Gjykatat ndërkombëtare për krime lufte nuk e kanë ndjekur këtë qasje për të vlerësuar besueshmërinë. Në njërin prej rasteve kryesore të GJNKR, Akayesu, shumica e atyre që dëshmuuan ishin dëshmitarë okularë të krimeve të kryera gjatë gjenocidit në Ruandë. Sa i përket deklaratave të tyre, oda gjyquese (trupi gjyqes) kishte vërejtur se mospajtueshmëritë dhe kontradiktat të cilat u shfaqën në mes të dëshmimeve gjatë seancës gjyquese dhe dëshmimeve të tyre të mëparshme dhënë prokurorëve dhe mbrojtësve...

“...si të vetme, nuk paraqesin bazë për të besuar se dëshmitarët kanë dhënë deklarata të rrejshme. Kritika që shpeshherë i arkëtohet dëshmisë, në të vërtetë, paraqet rrëzueshmërinë e saj. Kjo kritikë është edhe për t’u pritur, pasi që, deklaratat shpeshherë bazohen kryesisht në kujtesë dhe në atë çka është parë, e që këto të fundit janë dy karakteristika njerëzore të cilat shpesh e mashtrojnë individin. Prandaj, dëshmia rrallë herë është e saktë përkitazi me ngjarjet e përjetuara. Largimi nga kontradiktat dhe pasaktësitë rezultuese se ka pasur dëshmi të rrejshme, do të ishte shumë i afërt me aktin e penalizimit të dobësive të perceptimeve njerëzore. Për më tepër, pasaktësitë dhe kontradiktat në mes të deklaratave të dhëna dhe dëshmimeve të dhëna para gjykatës, janë gjithashtu rezultat i hapësirës kohore në mes këtyre dyjave. Me kalimin e kohës kujtesa, natyrisht zbehet, andaj do të ishte gabim dhe e padrejtë për trupin gjyqes që të trajtoj harresën njësoj sikur të ishte dëshmi e rrejshme.”⁶⁰

Krahas kësaj, gjykimi i Akayesit theksoi se gjatë vlerësimit të dëshmimeve të dëshmitarëve, mori parasysh se tronditjet e vuajtura nga dëshmitarët të cilët ishin viktimat, apo dëshmitarë okular, të krimeve, mund “të ndikojnë në aftësitë [e dëshmitarit] për të përkujtuar plotësisht apo në mënyrë të duhur pjesë të ngjarjeve në kontekstin gjyqësor”.⁶¹ Gjykimi i Akayesut mëtej thekson se sfidat e paraqitura nga interpretimi i gjuhës vendëse nga dëshmitarët në gjuhën e tribunalit, dhe nga nevoja e vazhdueshme për të vënë fjalët dhe shprehjet e gjuhës vendëse në kontekst kohor dhe hapësinor.⁶² Përfundimisht, gjykata

⁵⁷ Nikoliq (rigjykim), Jovanoviq/Kolashinac, Apostoloviq, Misiq/Jovanoviq, dhe Stanojeviq.

⁵⁸ Trajkoviq dhe Matiq.

⁵⁹ Në tri raste – Matiq (rigjykim), Jokiq (rigjykim), dhe Mlladenoviq – kolegji ndërkombëtar ka shpallur aktgjykimin me gojë por ende nuk ka dhënë verzionin e shkruar.

⁶⁰ Prokurori kundër Akayesy, GJNKR 96-4-T, Vendimet e Trupit Gjyqes të 2 shtatorit 1998, paragrafi 140.

⁶¹ Akayesu, lartë në paragrafin 142 (në tekstin e mëtejshëm Akayesu)

⁶² Akayesu, lartë në paragrafin 145 dhe 146.

në rastin Akayesu deklaroi se ka marrë parasysh edhe faktorët kulturor që kanë ndikuar në deklaratat e dëshmitarëve, dhe se nuk ka “marrë ndojnë përfundim të kundërt përkitazi me besueshmërinë e dëshmitarëve të bazuar vetëm në qëndrimin e tyre të terhjekur dhe ndonjëherë në përgjegjet e tyre jo të drejtëpërdrejta në pyetje.”⁶³

Të gjitha rrethanat e përmendura në rastin Akayesu – kalimi i kohës, traumat, interpretimi i gjuhës, dobësimi i perceptimit dhe kujtesës, dallimet kulturore në komunikim – ishin prezente në gjykimet për krime lufte në Kosovë. Megjithatë, kolegjet ndërkombëtare gjatë vendosjes së rasteve nuk kanë adoptuar qasjen e artikuluar në rastin Akayesu. Në vend të kësaj, shumë kolegje gjykuese të Kosovës mbështeten, gjatë vendosjes mbi besueshmërinë, në pajtueshmërinë në të gjitha pikat e dëshmisë, përfshirë edhe përshkrimin e detajeve të imta, siç është ngjyra e uniformës dhe përshkrimi i armës.

Vetëm në njërin rast, Stanojeviq, gjykatësi ndërkombëtar ka adresuar gjërësisht se çfarë rrethanash ka pasur ajo parasysh gjatë vlerësimit të besueshmërisë. Ky gjykatës ka cituar si ndikime potenciale në besueshmërinë e dëshmitarit:

- Stresin, frikën, dhe kalimin e kohës⁶⁴;
- “armiqësinë etnike dhe presionin për dënim të manifestuar nga komuniteti vendës [Shqiptar]...”⁶⁵; dhe
- “publicitetin vendës dhe ndërkombëtar ...Duket se disa nga dëshmitarët mund të kenë pranuar si të vërtetë thashethemet e tilla dhe informatat e përhapura, dhe në mënyrë të ndërgjegjshme apo jo, kanë lejuar të deformohen rrëfimet e tyre për ngjarjet kritike.”⁶⁶

Gjykatësi gjithashtu theksoi se gjykata nuk mund të konsideroj dëshmitarin si të pabesueshëm duke u bazuar vetëm në përkatësinë e tyre etnike, por shton:

“Nuk mund të thuhet se urrejtja etnike asnjëherë nuk ka qenë bazë për dyshim në besueshmërinë e ndonjë dëshmitari të caktuar. Një përfundim i tillë, sidoqoftë, është bërë vetëm në dritë të rrethanave të secilit dëshmitarë individualisht, kyqjen e tij apo saj në ngjarje dhe interesin në procedurë dhe shqetësimet e tilla sa mund të materializohen bazuar në prova”.⁶⁷

Çështja të cilës gjykatësi i referohet në rastin Stanojeviq, se a janë dëshmitarët shqiptarë të Kosovës në rastet e krimeve të luftës dëshmitarë të besueshëm dhe kredibil, doli sërish në sipërfaqe në aktgjykimin e Nikoliqit. Këtu, gjykatësi ndërkombëtar komentoi:

“Argumenti i paraqitur nga mbrojtësit, se është në relacion me mentalitetin e shqiptarëve të Kosovës që më tepër të përmbushin pritjet e kolegëve të tyre se sa pritjet e gjyqësisë, është e kuptueshme sikurse edhe frika e të akuzuarit të konfrontuar me gjykim dhe hetime të përjetuara si plotësisht armiqësore... Ndonëse kjo sjellje është e kuptueshme, nuk është e mundur të bazohet aktgjykimi në prova të tilla.”

⁶³ Akayesu, lartë në paragrafin 155 dhe 156.

⁶⁴ Stanojeviq, në paragrafin 152.

⁶⁵ Stanojeviq, në paragrafin 153.

⁶⁶ Stanojeviq, në paragrafin 154.

⁶⁷ Stanojeviq, në paragrafin 156.

Nuk është e qartë se çka ka menduar këtu gjykatësja kur supozon “të kuptueshëm” argumentimin e mbrojtësit mbi “mentalitetin e shqiptarëve të Kosovës që më tepër të përmbushin pritjet e kolegëve të tyre se sa të përmbushin pritjet e gjyqësisë”. Kjo sygjeron se, në mungesë të çfarëdo dëshmie eksperte përkitazi me organizimin shoqëror të shqiptarëve Kosovar apo modeleve komunikuese, gjykata supozoi konkluzione kontradiktore përkitazi me dëshmitarët e prokurorisë, të bazuara vetëm në përkatësinë e tyre etnike. Vetëm disa paragrafe më heret, gjykata konstatoi se, me disa përjashtime, “të gjithë dëshmitarët/palët e dëmtuara ...nuk i përmbahen gjithmonë të vërtetës, disa nga ata në mënyrë evidente, e disa nga ta në mënyrë më pak të dukshme.”

Këto dy aktgjykime bashkarisht aludojnë në çështjen se a duhet dhe kur duhet gjykata të marrë në konsiderim, gjatë vlerësimit të besueshmërisë së dëshmitarit, pozitën e tij apo saj si viktimë në një konflikt etnik. GJNKL në rastin Tadiq flet për këtë si në vijim:

“ Besueshmëria e dëshmitarëve, përfshirë çfarëdo motivi që ata mund të kenë për të dhënë dëshmi të rreme, është një vlerësim i cili duhet të bëhet në rast të secilit dëshmitar individualisht. Nuk është as e përshtatshme e as korrekte, të vijsh në përfundim se një dëshmitar konsiderohet të jetë definitivisht i pabesueshëm vetëm pse ai ishte viktimë e krimi të kryer nga personi i të njëjtit religjion, grup etnik, forcë të armatosur apo karakteristikë tjetër e të akuzuarit. Kjo nuk do të thotë se urrejtja etnike, madje edhe pa influencime të përkeqësuar të konfliktit të dhunshëm në mes të grupeve etnike, nuk mund të jetë asnjëherë bazë për dyshimin në besueshmërinë e ndonjë dëshmitari të caktuar. Një përfundim i tillë mund të mirret, megjithatë, në dritë të rrethanave të secilit dëshmitarë individual, dëshmisë së tij individuale, dhe shqetësimeve të tilla të cilat mbrojtësit mund t'i materializojnë gjatë marrjes në pyetje apo përmes provave kryesore”⁶⁸

Në rastet në të cilat mbrojtësit, prokurori, apo anëtari i kolegjit e shtron çështjen se dëshmitari mund të jetë i pabesueshëm bazuar në armiqësinë etnike apo presionin nga komuniteti, do të ishte mirë për gjykatën që në mënyrë strikte të ndjekë udhëzimet nga vendimi i Tadiqit. Kjo do të thotë se gjykata duhet të artikuloj se pse anshmëria e pandehur etnike është apo nuk është e mbështetur nga provat e rrethanave individuale të dëshmitarit dhe deklaratës së tij.

Përkthimet

Gjykimet për krime lufte në Kosovë, të udhëhequra nga gjykatësit ndërkombëtar janë zhvilluar në më shumë se një gjuhë. Dëshmitarët dëshmojnë në gjuhën shqipe apo serbe dhe kjo pastaj përkthehet në gjuhën angleze në mënyrë që gjykatësit ndërkombëtar të kuptojnë dhe kryetari i kolegjit të mund të përmbledhë dëshminë për procesverbal. Kualiteti i përkthimit gjuhësor dhe interpretimit në gjykatat e Kosovës është jo i njëjtë dhe shpeshherë i gabuar për shkak të dështimit të përkthyesve për të kuptuar dialektin vendës (përkthyesit shqip-anglisht në gjykatat e Kosovës janë nga Shqipëria e jo nga Kosova). Për më tepër, shumë nga përkthyesit gjyqësor nuk janë profesionalisht të trajnuar për përkthyes, dhe nuk kanë përvojë paraprake nga gjykatëria dhe seancat gjyqësore.

⁶⁸ Prokurori kundër Tadiqit, IT-97-1, Vendimi i Trupit Gjyqësor i 7 majit 1997, paragrafi 54.

Problemi i interpretimit gjuhësor të pëparshatshëm në gjykimet për krime lufte, komplikon më tej çështjen e vendosjes se a ka dëshmuar dëshmitari në mënyrë të paqëndrueshme. Kjo është shqetësuese sepse përkthyesi mund të përkthej deklaratën e dëshmitarit më mirë, me një nuancë tjetër, apo më keq, jo saktë dhe jo plotësisht, gjykatësit mund të konsiderojnë se dëshmitari nuk është bindës andaj nuk është i besueshëm.

Saktësia e shkrimit të dëshmisë së marrë në hetime dhe gjatë gjyqimit në procesverbal

Element qenësor në vendosjen se a ka dëshmuar dëshmitari në mënyrë të qëndrueshme apo jo, është saktësia dhe besueshmëria e mekanizimit për shkrimin e deklaratës së dëshmitarit. Në gjykatat e Kosovës, gjatë dëgjimeve hetimore gjyqësore dhe gjykimeve, dëshmitë e dëshmitarëve zakonisht nuk shkruhen verbatim (fjalë për fjalë). Sipas LPP RFJ 80(2), “vetëm gjërat esenciale të dëshmisë dhe deklaratat e dhëna do të shkruhen në procesverbal në formë tregimi. Pyetjet do të futen në procesverbal vetëm nëse kjo është e domosdoshme për të kuptuar përgjegjëjen.”

Praktika në gjykatat e Kosovës është që, pasi që dëshmitari t’i përgjigjet një serie pyetjesh mbi rastin, kryetari i kolegjit t’i diktoj procesmbajtësit parafrazimet mbi atë se çka ka thënë dëshmitari. Kjo metodë, zakonisht e përdorur në sistemet civile juridike, mund të shkaktoj ndryshime në frazimet, gjuhën apo stilin e deklaratës origjinale të dëshmitarit. LPP RFJ 82(3) deklaron se “procesverbali duhet të nënshkruhet nga personi i cili është marrë në pyetje” por kjo vetvetiu nuk do të siguroj që deklaratat e përmbledhura në mënyrë të saktë të pasqyrojnë se çka ka thënë dëshmitari. OSBE-ja ka vërejtur se dëshmitarët shpesh nuk i lexojnë përmbledhjet gjyqësore të deklaratave të tyre para nënshkrimit, dhe se gjykatësi hetues zakonisht nuk insiston që dëshmitari të lexojë deklaratën para se ta nënshkruaj.

Inçizimi në trakë i hetimeve gjyqësore, dhe kopja e trakës së bërë, sipas LPP RFJ 87(1) dhe (5), është i mundshëm. Gjer më sot, megjithatë, as kolegjet hetimore e as ato gjyqësore nuk kanë përdorur inçizimin elektronik të rasteve të krimeve të luftës. Procesmbajtësit stenograf (që përdorin dorëshkrimin apo makinën stenografike) nuk ekzistojnë në Kosovë. Në dy raste të krimeve të luftës, Vuçkoviç dhe Apostoloviç, gjykata kishte shënuar në formën verbatim shumicën e dëshmive, duke bërë që procesmbajtësi t’i shtypë deklaratat e dëshmitarëve në kompjuter, gjatë dhënjes së dëshmive nga dëshmitarët. Sidoqoftë, kjo nuk është praktikë e zakonshme. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre rasteve, gjykatat të cilat mbështeten fuqishëm në analizat e asaj se, sa janë të qëndrueshme deklaratat e dëshmitarëve që kishin dëshmuar para një periudhe kohore, duhet të përdorin mjete më të sakta dhe të besueshme të shkrimit të deklaratave të dëshmitarëve.

Teoritë e përgjegjesisë penale në kontekstin e Kosovës

Disa raste të krimeve të luftës kyqin individët që vepronin vetëm. Në të kundërtën, shumica e raportimeve për krime lufte përshkruajnë akterë të shumëfishtë që kryejnë vepra penale në bashkëveprim (ndonëse rrallëherë janë identifikuar dhe akuzuar të gjithë

aktorët e kyqur). Se a ka të bëjë kjo çështje me një grup paramilitarësh që hyjnë në fshat me qëllim të largimit të civilëve dhe djegjes së shtëpive, apo me çështjen e eprorit civil apo ushtarak, i cili raportohet se me urdhër, inkurajim, apo tolerim të të nënshtruarve të tij, vepron në plaçkitje, veprime jonjerëzore apo torturim, gjykatat duhet të vlerësojnë dhe identifikojnë bazat ligjore të përgjegjësisë penale të të pandehurit në mënyrë individuale.

Ligji i aplikueshëm në Kosovë parasheh disa lloje të ndryshme të përgjegjësisë penale, në mes tyre ndihmën, bashkëveprimin, nxitjen, dhe përdorimin e grupit për të kryer vepra penale. Më tej, ligji i aplikueshëm dhe e drejta e konventave, sigurojnë një kornizë për të analizuar dhe mveshur përgjegjësinë për të nënshtruarit dhe për eprorët të pandehur të kenë kryer krime. Sidoqoftë, bazuar në aktgjykimet e gjykatave në këto raste të shqyrtuara, kolegjet nuk kanë aplikuar në mënyrë të duhur të drejtën ekzistuese ligjore dhe atë nga konventat mbi përgjegjësinë penale përkitazi me faktet në rastet individuale.

Vetëm dy nga aktgjykimet e shqyrtuara për krimet e luftës diskutojnë më gjërësisht mbi natyrën ligjore të përgjegjësisë penale të të pandehurit. Në njërin nga këto raste, Kollashinac, gjykatësi si çështje të lëndës, e identifikoi përgjegjësinë e komanduesit, dhe iu referua jurisprudencës së GJNKR, përkitazi me atë çështje.⁶⁹ Aktgjykimi në rastin Kollashinac përfundimisht konstatoi se i pandehuri, si kryetar i Kuvendit Komunal dhe si udhëheqës i njësitit komunal për mbrojtjen civile, nuk ka poseduar as pushtetin *de facto* as *de jure* mbi zyrtarët policor apo ushtarak.

Në rastin Trajkoviq, i pandehuri ishte udhëheqës i policisë, i akuzuar për përgjegjësinë për krimet e luftës të kryera nga të nënshtruarit e tij. Gjykatësi ndërkombëtar theksoi ligjet e RFJ dhe ato Serbe të cilat i jepnin të pandehurit pushtetin ligjor mbi të nënshtruarit e tij të cilët kryen krimet, dhe pastaj përfundoi përkitazi me çështjen e përgjegjësive penale se

“këto elemente të ndryshme konstituojnë provën se Momqillo Trajkoviq është personalisht përgjegjës për (sic) aktet penale të kryera në regjionin e Kamenicës kundër popullatës civile, por vetëm për akcionet e organizuara e jo për ato të izoluar.”

Këtu gjykatësi duket se ka pranuar një lloj dallimi në mes të përgjegjësive për “akcionet e organizuara” dhe përgjegjësinë për ato të “izoluara”, por asnjëherë nuk ka definuar se çka konstituon akcionet “e organizuara” e çka ato “të izoluar”, dhe asnjëherë nuk artikuloi parametrat e ndryshëm të përgjegjësive në mes të këtyre dyjave. Gjykatësi gjithashtu asnjëherë nuk specifikoi se a bazohet përgjegjësia penale për veprat penale “të organizuara” në ligj apo në ndonjë burim tjetër .

Aktgjykimet tjera gjyqësore të shqyrtuara, si ato të përpiluara nga kolegjet ndërkombëtare ashtu edhe nga kolegjet vendëse, ose përshkruajnë përgjegjësinë e të pandehurit si të kishte qenë në bashkëveprim, në pajtim me LP RFJ 22, ose fare nuk e përmendin këtë çështje.

⁶⁹ Diskutimi i gjykatës përkitazi me atë çështje prezumonte mbi zbatueshmërinë e doktrinës së përgjegjësive komanduese në gjykatat e Kosovës, pa përmendur se a ishte zbatuar ajo si e drejtë zakonore ndërkombëtare, apo nga fuqia e nenit 86 dhe 87 të Protokollit Shtesë Nr.1 të Konventave të Gjenevës.

Mungesa më e madhe e vërejtur në aktgjykimet gjyqësore është dështimi i tyre për të njohur apo për të theksuar teoritë e përegjegjësive individuale të bazuara mbi pjesëmarrjen e të akuzuarit në një grup kriminal. LP RFJ 26 (Përgjegjësia penale dhe dënueshmëria e organizatorëve të veprimtarisë penale) mund të aplikohet në këto instanca, të cilat janë analoge me doktrinën ndërkombëtare zakonore të organizatës së bashkuar kriminale (e njohur gjithashtu edhe si doktrina e qëllimit të përbashkët), siç interpretohet nga GJNKL në rastet si Tadiq⁷⁰ dhe Brdanin dhe Taliq.⁷¹

Pasiqë praktikisht të gjitha rastet e krimeve të luftës në Kosovë kanë kyqur raportimet dhe provat për grupet e uniformuara dhe të armatosura ushtarake të cilat, duke vepruar në bashkim, kryen veprat penale të shkatërrimit të pasurisë, kërcënimit, torturimit, vrasjeve dhe shpërnguljeve të civilëve, është logjike që ndjekja duhet të vazhdojë, dhe gjykata duhet të marrë në konsiderim, përgjegjësinë sipas LP RFJ 26 dhe doktrinën e organizatës kriminale të bashkuar. Kur provat janë të qarta dhe i pandehuri me qëllim ka marrë pjesë si anëtar i grupit të angazhuar në aktivitete kriminale, gjykatat duhet të aplikojnë LP RFJ 26 dhe të jenë të udhëhequra nga rastet e organizatave kriminale të bashkuara. Dështimi për të marrë këtë në konsiderim dhe, kur mbështetet nga provat, të aplikojë këtë doktrinë të përgjegjësive mund të rezultojë në atë që i pandehuri të mos mbahet plotësisht përgjegjës për pasojat e parapara të veprave të tyre penale.

Nuk është e qartë se dështimi për të raportuar apo marrë në konsiderim këtë bazë për përgjegjësinë penale buron nga mos-afërsia e prokurorëve edhe gjykatësve me ligjin e aplikueshëm dhe autoritetet ligjore, apo për shkak se gjykatësit dhe prokurorët nuk ishin siguruar, e gjykatësit nuk kishin insistuar, në provat e dhura të pranueshme mbi organizatën e bashkuar kriminale. Pavarësisht nga shkak, duke shqyrtuar provat në gjykimet për krimet e luftës në Kosovë, duke shikuar aktivitetin kriminal vetëm në aspektin individual, apo, të shumtën, në bashkëveprim, gjykatat rrezikojnë të vlerësojnë jashtë kontekstit, krimet e pandehura.

Kolegjet gjyqësore vendëse në ndjekjet e mëhershme të krimeve të luftës ndonjëherë shkojnë në drejtim të kundërt, duke nxjerrë përfundime të hovshme përkitazi me atë se çka ata konsiderojnë forca të mëdha kriminale të angazhuara gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. Për shembull, gjykata në rastin Jokiq konstatoi se aktet penale të të pandehurit:

“kishin qëllim (sic) shpërnguljen masive të civilëve të pambrojtur të popullatës shqiptare nga trojet e veta dhe si hap përfundimtar spastrimin etnik të Kosovës.”

Dhe në rastin Ademi, kolegji vendës deklaroi se

“Gjithashtu janë vërtetuar deportimet masive të popullatës civile në Kosovë, të shumtën gra, fëmijë, pleq, të ndaluara sipas konventave ndërkombëtare, duke i lënë ata të uritur pa mjete elementare për jetesë. Gjithashtu edhe sjellja e të akuzuarit ndaj integritetit trupor e tani të ndjerit, ekzekutimet, vrasjet ... dhe trajtimi jonjerëzor si marrja e të hollave, djegja e shtëpive, deportimi masiv nga shtëpitë e tyre...”

⁷⁰ Tadiq, Vendimi i Trupit Gjyqësor të Apelacionit në paragrafet 186-228.

⁷¹ Brdanin dhe Taliq në 22-51.

Deklaratat e tilla nuk ishin të mbështetura nga provat e administruara në gjykime (të cilat ishin të përqëndruara në ngjarjet e ndodhura në komunën e Prizrenit dhe, respektivisht Mitrovicës). Qasja në këto dy raste dështon të ndjekë çfarëdo kriteri ligjor për zbulimin e fajësisë bazuar në pjesëmarrjen në organizatën e bashkuar kriminale.

Sidoqoftë, aty kishte një sasi të madhe provash të besueshme të pranuar në një numër të konsiderueshëm rastesh gjer më tani përkitazi me shpërnguljen, kërcnimet dhe dhunën kundër civilëve, si dhe shkatërrimin e qëllimtë të pasurisë. Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar të cilët tani marrin përgjegjësinë për gjykimet e krimeve të luftës në Kosovë, duhet të jenë të përgatitur për të lokalizuar, vlerësuar dhe pranuar provat të cilat tregojnë një kontekst më të gjërë të krimeve individuale të të pandehurit. Ata duhet, për më tepër, të marrin në konsiderim provat e tilla, kur kjo është e përshtatshme, në dritë të ligjit të aplikueshëm mbi aktivitetin grupor penal (LP RFJ 26), dhe në dritë të doktrinës së mirë të organizuar të organizatës së bashkuar kriminale. Kjo është me rëndësi me qëllim që gjykatat Kosovare të artikulojnë kontekstin në të cilin krimet janë paraqitur, të vlerësojnë provat, dhe në mënyrë të plotë dhe korrekte të administrojnë drejtësinë në këto raste komplekse.

Struktura dhe rezultatet në aktgjykimet gjyqësore

Duke marrë në konsiderim rëndësinë e ndjekjeve penale në krimet e luftës së Kosovë, për promovimin e hulumtimit të se vërtetës dhe pajtimit në regjion, aktgjykimet gjyqësore duhet të reflektojnë standardet e larta të jurisprudencës. Aktgjykimet në rastet e kësaj natyre pritet të jenë për nga struktura konsistente dhe të përcjellura me arsyetim solid ligjor. Karakteri univerzal i këtyre krimeve dhe vëmendja publike të cilën ato zakonisht tërheqin do të thotë se aktgjykimet konsiderohen si trup mendimesh ligjore, të cilat, me fuqinë e kualitetit të tyre, mund të formojnë një jurisprudencë të zëshme që ka qëllim udhëzimin apo sigurimin e referencave gjatë gjykimeve të ardhshme të ngjashme, apo për profesionalistët ligjor të interesuar për hulumtimin e rasteve të tilla. Për më tepër, duke pasë në konsiderim se kolegjet gjyqësore që dëgjojnë këto raste të shumtën janë në përbërje nga gjykatësit ndërkombëtar, standardet e shkrimit ligjor dhe argumentimit duhet të jenë akoma më të larta.

Ndarazi nga aspektet e analizave ligjore, të cilat janë diskutuar në pjesën tjetër të këtij raporti, struktura dhe organizimi i aktgjykimeve në rastet e krimeve të luftës të analizuara këtu, në disa raste kanë dështuar të ndjekin standardet e përmendura më lartë. Ligji i aplikueshëm, përkatësisht kreu XXII i LPP RFJ, i numëron llojet e aktgjykimeve të cilat mund të shpallen nga gjykata, dhe gjithashtu shpjegon elementet e domosdoshme strukturale dhe substanciale të cilat llojet e ndryshme të aktgjykimeve mund t'i kenë. Sipas dispozitave të LPP RFJ 357, aktgjykimi duhet të përmbajë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin. Sa i përket shpjegimit, paragrafi 7 i nenit të përmendur thotë se tri nga elementet kryesore të tijë janë përcaktimi i ekzistimit të krimit, përcaktimi i përgjegjësisë penale, dhe vlerësimi ligjor i veprës apo lëshimit për të cilin i pandehuri është gjetur të jetë përgjegjës. E vetmja situatë ku ligji i aplikueshëm parasheh se tri elementet e përmendura më lartë, nuk duhet të vlerësohen, është kur gjykata shqipton aktgjykimin me të cilin refuzohen akuzat, bazuar në LPP RFJ 349. Përkundrazi, vlerësimi përkitazi me

ekzistimin dhe natyrën ligjore të krimit, dhe vlerësimi i përgjegjesisë penale të të pandehurit janë elemente të obligueshme të aktgjykimit, madje edhe kur i pandehuri është shpallur i pafajshëm dhe është liruar. Në të vërtetë, LPP RFJ në mënyrë strikte parasheh tri situatat e veçanta në të cilat i pandehuri mund të lirohet (neni 350), por në asnjë nga këto situata gjykata në asnjë rast nuk është përjashtuar nga LPP RFJ 357, nga ofrimi i vlerësimit ligjor të krimit, natyrës së tij dhe përgjegjesisë penale.

Gjatë analizës së disa nga aktgjykimet në rastet e krimeve të luftës në Kosovë, mungesa e kuptimit të përbashkët të unifikuar të strukturës dhe elementeve të domosdoshme të aktgjykimit është më se e dukshme. Shumica e aktgjykimeve gjyqësore, nga kolegjet vendëse apo ndërkombëtare, nuk e bëjnë dallimin në mes të çështjeve ligjore dhe atyre faktike, dhe ato nuk i vendosin elementet e veprës penale të ngarkuar dhe analizojnë provat gjyqësore duke iu referuar atyre. Për më tepër, përkundër faktit se akuzat për krime lufte janë jashtëzakonisht serioze dhe se ato kërkojnë, si parakusht esencial, ekzistimin e një varg rrethanash specifike, kolegjet gjyqësore nuk i kanë adresuar çështjet, esenciale për të vërtetuar rastin *prima facie*, siç është ekzistimi i konfliktit të armatosur apo i “rregullave të së drejtës ndërkombëtare” të shkelura sipas LP RFJ 142.

Për shembull, aktgjykimi i Nikoliqit, i shkruar nga gjykatësi ndërkombëtar, fillon me vendosjen e përmbledhjeve të deklaratave të secilit dëshmitar, dhe vazhdon me pjesët e titulluara “korniza kohore”, “uniformat dhe armët”, dhe “besueshmëria”. Rasti Nikoliq përfshinë raportimet se i pandehuri ishte anëtar i një grupi të armatosur dhe uniformuar të policisë/paramilitarëve serb, të cilët hynë në banesën e viktimës dhe e vranë atë. Megjithatë, aktgjykimi gjyqësor asnjëherë nuk ka specifikuar konstatimin se a është kryer krimi si dhe, substancën apo natyrën e krimit. Ai vetëm vuri në pah se identifikimi i të pandehurit ishte joadekuat.

Në aktgjykimin e parë të Jokiqit, gjykata paraqiti në mënyrë të gjërë deklaratat e dhëna nga dëshmitarët dhe i dha rëndësi të madhe pjesës tjetër të provave të administruara gjatë gjykimit, vetëm e vetëm për të konkluduar, në një paragraf të shkurtër, se i pandehuri ishte fajtor për veprat e kryera të krimeve të luftës. Aktgjykimi nuk përmbante vlerësim faktik apo ligjor përkitazi me ekzistimin e konfliktit të armatosur, asnjë analizë ligjore për aktet e pohuara të jenë kryer nga i pandehuri nga perspektiva e “rregullave të së drejtës ndërkombëtare”, të kërkuara sipas LP RFJ 142, dhe asnjë referencë ndaj ndonjë teorie për përgjegjësinë penale.

Mungesë e ngjashme e një vlerësimi ligjor të organizuar (strukturuar) mirë, mbi krimet e kryera, është gjetur edhe në aktgjykimin e Stanojeviqit.

Një shembull i praktikës më të mirë gjendet në aktgjykimin e Jovanoviqit/Misiçit.. Këtu, gjykata konstatoi se “ngjarjet në përgjithësi ndodhën ashtu siç deklarohet nga dëshmitarët” (rradhitja e fshatarëve shqiptarë nga forcat serbe, ndarja e mashkujve nga femrat, dhe torturimi dhe keqtrajtimi i fshatarëve mashkuj), por pastaj përcaktohet se të pandehurit nuk ishin identifikuar si pjesëmarrës në veprat penale.

Vetëm në një aktgjykim, Kollashinac/Jovanoviq, gjykata ka vendosur në mënyrë të qartë në strukturën e aktgjykimit të saj, faktet ashtu siç aplikohen në elementet e krimit.

Mungesa e autoritetit të përmendur

Shumica e aktgjykimeve gjyqësore, përfshirë edhe ato të shkruara nga gjykatësit ndërkombëtar, analizojnë çështjet ligjore vetëm duke iu referuar ligjit vendës (që janë ligjet penale të RFJ dhe Kosovës, dhe Ligji mbi procedurën penale të RFJ, dhe Rregulloret e UNMIK-ut). Ndonëse vetëm referimi në ligjet vendëse zakonisht është i mjaftueshëm për veprat penale që kyqin përcaktimet e thjeshta, të drejtëpërdrejta ligjore apo faktike, në rastet e krimeve të luftës, kompleksiteti dhe risitë e çështjeve të prezentuara zakonisht kërkojnë citimin e një rrethi më të gjërë të autorësive ligjore. Por, me një përjashtim, gjykatësit vendës dhe ndërkombëtar gjer më sot, në aktgjykimet e tyre të shkruara, nuk kanë bazuar vendimet e tyre në jurisprudencën ndërkombëtare për krimet e luftës dhe atë humanitare; e njëjta situatë është edhe për jurisprudencën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Vetëm dy aktgjykime gjyqësore i referohen praktikës gjyqësore për krime të luftës. Në rastin Trajkoviq, gjykatësi ndërkombëtar citoi vendimin e GJNKL në rastin Tadiq⁷² mbi definicionin e veprës së krimeve kundër njerëzimit sipas të drejtës ndërkombëtare zakonore. Megjithatë, ky gjykatës gabimisht konstatoi se krimet kundër njerëzimit (vepër kjo sipas të drejtës ndërkombëtare zakonore dhe shkelje e statutit të GJNKL), janë të ndara dhe dallojnë nga krimet e luftës sipas LP RFJ 142.

Vendimi i Kollashinac/Jovanoviq është i vetmi shembull në mes të aktgjykimeve gjyqësore nën shqyrtim, që në mënyrë të përshtatshme bazohet në praktikën gjyqësore dhe autorësisë tjetër. Autori i tij, citon një varg burimesh gjyqësore dhe mësimore, përfshirë mes tjerash, praktikën gjyqësore të GJNKL dhe GJNKR, komentet e ligjit penal të RFJ, dhe tekstin e krimeve kundër njerëzimit.

Vetëm një nga aktgjykimet e shqyrtuara i referohet praktikës gjyqësore të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Aktgjykimi i Stanojeviqit, ndonëse nuk përmend jurisprudencën e krimeve të luftës, i citon tri raste të GJEDNJ përkitazi me çështjet se a mund të hjeket dorë nga prezenca e të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës gjatë rekonstruimit të vendit të ngjarjes.⁷³

Kualifikimi jo i drejtë⁷⁴ i krimit

Katër kolegje gjyqësore ndërkombëtare kanë shpallur fajtor të pandehurit për krime që janë të ndryshme nga ato me të cilat akuzohen sipas aktakuzës.⁷⁵ Në rastin Matiq, kolegji ndërkombëtar rikualifikoi akuzën për krime lufte në lëndime të lehta trupore. Në rastin Kollashinac, gjykata kaloi prej krimeve të luftës, në dhënjën e ndihmës pas kryerjes së

⁷² Tadiq, Vendimi i Trupit Gjyqësor të Apelacionit, mëlartë.

⁷³ Stanojeviq, në paragrafin 15, fusnota 3.

⁷⁴ “Kualifikimi” është shprehje e përdorur në disa sisteme kontinentale të së drejtës për të përshkruar zgjedhjen e aktakuzës penale elementet e së cilës pajtohen me fakte të rastit specifik. Kur kolegjet ndërkombëtare në rastet e krimeve të luftës në Kosovë kanë “rikualifikuar” aktakuzat, ata kanë përcjellur procedurën e njëjtë të identifikimit të veprave të përfshira apo atyre më pak të përfshira.

⁷⁵ Shih Kollashinac, Matiq, Jokiç dhe Trajkoviq.

veprës penale. Në të dy këto raste Gjykata Supreme konstatoi se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në rikualifikimin e krimit të ngarkuar. Kolegji gjyqësor vendës në rastin Jokiç, pasi që nuk gjeti prova të qëllimit të të pandehurit për të shkatërruar një grup etnik apo kombëtar, pastaj rikualifikoi akuzën si krime lufte sipas LP RFJ 142 dhe gjeti të pandehurin fajtor për këtë. Ndonëse ishte shenjë premtuese se kolegjet vendëse më kujdes morrën në konsiderim çështjen e qëllimit në aktakuzën origjinale për gjenocid, rikualifikimi i tyre në krime lufte, LP RFJ 142, ishte një gabim i dukshëm ligjor⁷⁶ të cilin Gjykata Supreme asnjëherë nuk e adresoi kur e shqyrtoi rastin sipas ankesës.

Rikualifikimi tjetër fundamentalisht jo i drejtë, u paraqit në rastin Trajković, kur gjykatësi ndërkombëtar e ngatërroi akuzën ligjore për krime lufte sipas LP RFJ 142 me veprën e krimeve kundër njerëzimit nga e drejta ndërkombëtare zakonore. Aktgjykimi në këtë rast theksoi se LP RFJ 142, përfaqësoi kodifikimin e ligjeve të RFJ për krimet kundër njerëzimit (krimet kundër njerëzimit, janë vepra nga e drejta ndërkombëtare zakonore të cilat janë zhvilluar ndarazi në të drejtën ndërkombëtare nga veprat e krimeve të luftës). Ndonëse gjykata keqkarakterizoi LP RFJ 142 si “krimet kundër njerëzimit”, dhe lexoi atë nen elementet e një vepre krejtësisht tjetër, kolegji ndërkombëtar i Gjykatës.

IV. VENDIMET E GJYKATËS SUPREME

Pasqyrë

Vendimet e Gjykatës Supreme në Kosovë janë burime të zbehta të jurisprudencës për krimet e luftës. Ato karakterizohen me madhësi të shkurtër (mesatarisht prej tre deri në katër faqe), arsyetim të varfër ligjor, mungesë të citimeve të autoritetit ligjor dhe mungesë të interpretimit përkitazi me ligjin e zbatueshëm mbi krimet e luftës dhe të drejtat e njeriut. Për këtë shkak, ato nuk janë mjete të dobishme për ofrimin e udhëzimeve komunitetit ligjor në fushën e krimeve të luftës dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare.

Kolegjet ndërkombëtare të Gjykatës Supreme kanë kthyer në rishqyrtim tetë nga njëmbëdhjetë aktgjykimeve dënuese të lëndëve të krimeve të luftës të cilat i kishte shqyrtuar. Si arsye për kthim në rishqyrtim të këtyre aktgjykimeve dënuese ishte se faktet nuk ishin vërtetuar në mënyrë të drejtë. Nga gjashtë prej këtyre tetë, kolegji i Gjykatës Supreme theksoi se ishte gabim ligjor fakti se gjykata gjykuese nuk kishte ftuar dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja.

Bazat parimore për kthim në rishqyrtim të aktgjykimeve dënuese të lëndëve të krimeve të luftës që është “vërtetimi jo i plotë dhe i mjaftueshëm i gjendjes faktike”, kuptohet në mënyrë të ndryshme nga kolegjet të ndryshme të Gjykatës Supreme. Zakonisht, kolegjet e Gjykatës Supreme e përdorin këtë shprehje për të bërë me dije se thjeshtë nuk pajtohen me vendimin e gjykatës gjykuese se ekzistojnë prova të mjaftueshme për të vërtetuar se i pandehuri ka qenë i përfshirë në kryerjen e veprës penale. Disa kolegje, siç ishte kolegji

⁷⁶ Gjenocidit i mungon elementi i “luftës, konfliktit të armatosur, apo okupimit” me rëndësi thelbësore për të vërtetuar akuzën e krimeve të luftës sipas LP RFJ-së neni 142.

gjkues i rastit Trajkoviq dhe Kollashinac, përdorin një shprehje të tillë për të bërë me dije se gjykata gjykuese ka vendosur në mënyrë jo të drejtë përkitazi me faktin se të pandehurit mbahen penalisht të përgjegjshëm për kryerjen e veprave të caktuara penale të cilat në mënyrë të pakontestueshme kanë ndodhur. Kjo nënkupton se në raste të shpeshta gjykata nuk lejonte palën mbrojtëse për t'i thirrur disa dëshmitar të caktuar të saj.

Tabela e paraqitur mëposhtë paraqet një pasqyrë statistikore të dispozitivëve dhe arsyet e përdorura nga Gjykata Supreme gjatë kthimit në rishqyrtim të vendimeve të gjykatave gjykuese për rastet e krimeve të luftës.

<u>Vendimet e Gjykatës Supreme</u>		
<u>Rasti</u>	<u>Vendimi</u>	<u>Arsyet për kthim në rishqyrtim</u>
Nikoliq	Kthyer në rishqyrtim	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjendja faktike e vërtetuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë 2. Dështimi për t'i thirrur dëshmitarët e mbrojtjes
Vuqkoviq	Kthyer në rishqyrtim	<ol style="list-style-type: none"> 1. Baza të pamjaftueshme faktike për aktgjykim 2. Vlerësimi i gabuar i provave 3. Dështimi për t'i thirrur dëshmitarët e mbrojtjes
Zvezdan Simiq	Aktgjykimi i vërtetuar; Dënimi i zmadhuar	
Jokiq	Kthyer në rishqyrtim	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vërtetimi jo i plotë i fakteve 2. Dështimi për t'i thirrur dëshmitarët e mbrojtjes
Ajeti/ Stojanoviq	Kthyer në rishqyrtim	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vërtetimi jo i plotë i fakteve 2. Dështimi për t'i thirrur dëshmitarët e mbrojtjes 3. Dështimi për të pranuar dokumentacionin e mbrojtjes 4. Dështimi për të sqaruar kundërthëniet në mes të deklaratave
Stanojeviq	Aktgjykim & dënimi i vërtetuar	
Jovanoviq/ Kollashinac	Jovanoviq: Vërtetuar Kollashinac: Vërtetuar	(Kollashinac prishur) Vlerësimi i gabuar i provave për <ol style="list-style-type: none"> 1. Punën e detyruar

<u>Vendimet e Gjykatës Supreme</u>		
<u>Rasti</u>	<u>Vendimi</u>	<u>Arsyet për kthim në rishqyrtim</u>
		2. Urdhërave të dhëna/pranuara nga të pandehurit përkitazi me: djegjen e pasurisë&shkatërrimin 3. Pasojat e listave të regjistrimit
Matiq	Kthyer në rishqyrtim	1. Lëndimet e lehta trupore nuk janë përfshirë brenda akuzës për krime lufte 2. Vërtetimi i gabuar i fakteve
Trajkoviq	Kthyer në rishqyrtim	1. Mungesa e provave për përgjegjësinë penale 2. Dështimi për t'i thirrur dëshmitarët e mbrojtjes

Trajtimi i Gjenocidit, LP RFJ 141

Vetëm në një rast, atë të Vuçkoviqit, Gjykata Supreme e ka konsideruar krimin e gjenocidit në bazë të LP RFJ-së neni 141. Në këtë rast, gjykata nuk arriti të gjejë prova me të cilat do të vërtetohej elementi thelbësor që e përbën veprën penale të gjenocidit, e cila është qëllimi për të shkatërruar një grup kombëtar apo etnik pjesërisht apo në tërësi. Gjykata gjithashtu tha, *in dicta*, se:

“Veprat e kryera nga regjimi i Millosheviqit (sic) gjatë vitit 1999 nuk mund të kualifikohen si vepra penale të gjenocidit, pasi që qëllimi i tyre nuk ishte shkatërrimi i grupit etnik shqiptar pjesërisht apo në tërësi, mirëpo shpërngulja e dhunshme nga Kosova si rezultat i një fushate sistematike të terrorit duke përfshirë këtu edhe vrasjet, dhunimet, djegjet dhe keqtrajtimet e rënda. Këto vepra penale i përgjigjen definicionit të krimeve kundër njerëzimit të dhëna nga e drejta ndërkombëtare (plani gjithëpërfshirës apo sistematik i sulmit kundër popullatës civile gjatë luftës) apo mund të kualifikohet si krime lufte sipas nenit 142 LPJ-së.”

Deklarata e fundit paraqet një shembull mjaft interesant, për shkak se gjykata propozon një rregull të përgjithshme sa i përket zbatimit të dispozitave ligjore. Rasti i Vuçkoviqit nuk ofronte dëshmi të mjaftueshme në bazë të së cilës do të vërtetoheshin veprimet gjenocidale të regjimit të Millosheviqit si tërësi, mirëpo ajo ishte e kufizuar në vetëm ato veprime të cilat i kishte kryer i akuzuari në rajonin gjeografik të Mitrovicës. Përpjekjet për të ofruar udhëzime sa i përket interpretimit të çështjeve të caktuara ligjore mund të shkojnë në dobi të Gjykatës Supreme për shkak se në shumë raporte të saj⁷⁷ OSBE-ja ka inkurajuar këtë gjykatë që të marrë përsipër rolin udhëheqës në këtë aspekt. Megjithatë, në këtë rast konkret, Gjykata Supreme nuk morri përsipër rolin udhëheqës për të interpretuar natyrën ligjore dhe kuptimin e dispozitave që kanë të bëjnë me gjenocidin, mirëpo në vend të kësaj, ajo paraqiti vërejtjet e saj të përgjithshme sa i përket gjendjes faktike. Së këndejmi, nuk ishte e drejtë nga ana e kolegjit të Gjykatës Supreme që të

⁷⁷ Shih raportet e OSBE-së në dispozicion në websajt të OSBE-së: www.osce.org/kosovo/documents/reports/justice

shpreh mendimin e tij përkitazi me çështjen- se a kishte ndodhur ndonjë veprë penale e gjenocidit në Kosovë gjatë vitit 1999- që nuk ishte para tij.

Rasti Vučković ishte një mundësi për Gjykatën Supreme që në mënyrë të plotë të interpretojë dispozitat mbi gjenocidin LP RFJ 141, dhe të citojë jurisprudencën nga gjykatat dhe tribunatet tjera, me qëllim të mbështetjes së përfundimeve të saj se provat e prezentuara gjatë gjykimit nuk vërtetonin kryerjen e veprës penale të gjenocidit. Shpërndarja e një mendimi të arsyetuar mirë përkitazi me këtë çështje nëpër tërë komunitetin ligjor do të ishte një mjet tejet i përshtatshëm për rritjen e shkallës së të kuptuarit të kësaj teme tejet të ndërlikuar dhe kontraverze.

Trajtimi i Krimeve të Luftës Kundër Popullatës Civile, LP RFJ 142

Ngjashëm, Gjykata Supreme ka dështuar të jep ndonjë mendim të hollësishëm në të cilin trajtohen elementet e dispozitave të krimeve të luftës nga LP RFJ 142, dhe mënyra se si duhet përcaktuar përgjegjësinë penale në bazë të kësaj. Çështjet me rëndësi kritike në bazë të kësaj dispozite janë “shkelja e rregullave të së drejtës ndërkombëtare”, ekzistimi i “kohës së luftës, konfliktit të armatosur, apo okupimit”, dhe çka përbën urdhër për kryerjen e veprave penale të parashikuara.

Në pesë raste, Gjykatës Supreme i ka hyrë në punë vetëm dispozita mbi krimet e luftës LP RFJ 142. Në tri nga pesë këto raste, Jokiq, Jovanović, dhe Trajković, gjykata i dënoi të pandehurit sipas akuzave për krime lufte. Në dy rastet tjera, Matiq dhe Kollashinac, akuzat e ngritura para gjyqit ishin për krime të luftës, mirëpo të pandehurit ishin shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale të ndryshme (lëndime të lehta trupore respektivisht dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës). Pas inicimit të procedurës ankimore, kolegjet ndërkombëtare të Gjykatës Supreme kthyen këto akgjykime dënuese në rishqyrtim.

Paragrafi në vijim, i cituar fjalë për fjalë nga vendimi i Gjykatës Supreme në rastin Trajković, është një shembull i arsyesimit të cilin kolegjet ndërkombëtare e kshin përdorur për të analizuar për të vërtetuar se a ekzistojnë baza të mjaftueshme ligjore dhe faktike për shpalljen fajtor të një personi për krime të luftës.

Gjykata Supreme gjeti se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht përkitazi me të gjitha akuzat, pasi që nuk ka provë të drejtëpërdrejtë përfundimtare se i akuzuari ka vepruar personalisht apo ka dhënë urdhëra që kanë sjellur gjer tek krimet e pandehura apo se ai mund të mbahet përgjegjës për detyrat e përgjegjësisë komanduese në lidhje me krimet e lartpërmendura, dhe nuk ekzistojnë prova të cilat tregojnë qëllimin me vetëdije në rastin e tentimvrasjes e as ndonjë fakt që do të vërtetonte përfundimin e pajustificuar të hudhjes së personit jashtë dritares.

Duke iu referuar faktit se a “kishte dhënë i pandehuri urdhëra të cilat kishin rezultuar në kryerjen e krimeve të pohuara apo se a mund të mbahet penalisht i përgjegjshëm për detyrat që i kishte kryer si rezultat i përgjegjësisë së tij komanduese në lidhje me krimet e përmendura mëlartë”, Gjykata Supreme aludon në doktrinën ligjore të përgjegjësisë komanduese. Kjo është një doktrinë e cila ka të bëjë me përgjegjësinë penale të shtjelluar gjatë proceseve gjyqësore të Nyrnbergut dhe Tokios pas Luftës së Dytë Botërore, në

statutet e GJNKL-së dhe GJNKR-së, dhe në gjykimet e GJNKL-së dhe GJNKR-së.⁷⁸ Ky raport tanimë ka arritur të adresojë me sukses çështjen e aplikimit të teorive të përgjegjësisë së bashkuar apo përgjegjësisë komanduese në aktgjykimet gjyqësore, ku të njëjtat argumente dhe analiza aplikohen edhe për vendimet e Gjykatës Supreme.

Trajtimi i përgjegjësisë penale

Përgjegjësia penale është një çështje ligjore. Ajo paraqet një përcaktim të asaj se a e bëjnë veprimet e tij, të akuzuarin penalisht të përgjegjshëm në bazë të parimeve të të drejtës penale. Megjithatë, vendimet e Gjykatës Supreme në rastet e krimeve të luftës nuk e ndajnë çështjen e përgjegjësisë penale të të akuzuarit nga çështjet faktike të rastit. Siç ilustron edhe me rastin Trajković, kolegjet e Gjykatës Supreme e konsiderojnë çështjen e përgjegjësisë penale si pjesë e “gjendjes faktike” të cilën gjykata gjyqësore duhet ta vërtetojë. Një ngatërrim i tillë i gjendjes faktike me çështjet ligjore ua vështirëson punën gjykatave të instancës më të ulët dhe praktikantëve gjatë identifikimit në mënyrë të drejtë të gabimeve që i bëjnë.

Për më tepër, shumica e rasteve të krimeve të luftës përfshijnë çështje të ndryshme sfiduese që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale. Në rastet e tilla, të pandehurit të cilët pohohet të kenë vepruar në bashkërenditje me të tjerët – qoftë si udhëheqës apo pjesëtar i njësiteve ushtarake, paramilitare apo policore, apo si civilë me *de facto* apo *de jure* pushtet mbi personat që i nënshtrohen urdhërave të tij. Mu për këtë arsye gjykatat duhet të vendosin se a janë të akuzuarit penalisht të përgjegjshëm në aspektin individual (si kryes, ndihmës, bashkëkryes, nxitës apo për tentim të kryerjes së një vepre penale), apo duhet të mbahen penalisht të përgjegjshëm për shkak se kanë formuar apo shfrytëzuar një grup të caktuar për të kryer një krim.⁷⁹ Në rastet kur provat sugjerojnë, apo kur të pandehurit pohojnë, se ai apo ajo “vetëm kishin zbatuar urdhërat” si ushtarë të thjeshtë (siç bëri Stanojeviq në në teorinë e tij alternative të mbrojtjes), gjykata do të duhej të vendoste se a aplikohet neni 239 i LP RFJ-së (përkitazi me përgjegjësinë penale të personave që i nënshtrohen urdhërave për ekzekutimin e atyre urdhërave) apo jo.

Asnjë nga rastet e Gjykatës Supreme nuk ka arritur të vendosë parametrat për vendosjen e bazave të ndryshme ligjore për përgjegjësinë penale. Në dy vendime të Gjykatës Supreme, rasti Kollashinac dhe ai Trajković, në të cilat ishin ngritur çështje të ndryshme mbi përgjegjësinë e eprorëve për krimet e kryera nga nënoficerët e tyre, gjykata nuk ka adresuar çështjen e përgjegjësisë penale të eprorëve, ose në bazë të klauzulës për “urdhërin” nga neni 142 LP RFJ-së ose në bazë të nenit 26 LP RFJ-së për përgjegjësinë si krijues apo shfrytëzues i organizatës kriminele. Sërish, ky dështim i Gjykatës Supreme për të identifikuar dhe analizuar qartë një çështje me rëndësi kritike në rastet serioze dhe komplekse, pasqyrohet në kredibilitetin e gjykatave.

⁷⁸ *Akayesu*, në paragrafet 487-491; *Prokurori kundër Aleksovski*, IT-95-14/1, Vendimi i Seksionit Gjyqësor i datës 25 Qershor 1999, paragrafet 66-81; *Prokurori kundër Delalic, dhe Landzo*, IT-96-21, Vendimi i Trupit Gjyqësor i datës 16 nëntor 1998, paragrafet 330-395.

⁷⁹ LP RFJ 26.

Mungesa e autoritetit të përmendur

Vendimet e shqyrtuara të Gjykatës Supreme nuk i referohen ndonjë autoriteti udhëzues apo bindës përveç Ligjit penal dhe Ligjit të procedurës penale të RFJ-së dhe Rregulloreve të UNMIK-ut. Asnjë nga vendimet nuk citon ndonjë rast nga gjykatat vendëse apo nga tribunalet ndërkombëtare për krimet e luftës; asnjë nga vendimet nuk citon konventat ndërkombëtare apo ligjet analoge nga shtetet tjera.

Përpos ligjeve të RFJ-së dhe Kosovës dhe Rregulloreve të UNMIK-ut, ekzistojnë vetëm dy referime të gjykatës ndaj autoriteteve me natyrë obliguese. Në rastin Trajković, gjykata theksoi se “Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut është e zbatueshme, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 dhe 2000/59”, e mëpastaj vazhdoi me dhënien e udhëzimeve gjykatava më të ulta përkitazi me atë se si duhet rivlerësuar çështja e paraburgimit të të pandehurit. Në rastin e Stojanovićit, gjykata citoi, pa diskutuar më tutje, nenin 6/3(d) të KEDNJ-së mbi dëgjimin e dëshmitarëve të mbrojtjes.

Ofrimi i analizave dhe civateve të hollësishme të rasteve përkatëse dhe autoriteteve tjera në kuadër të vendimeve të Gjykatës Supreme, do t’i ndihmojë në masë të madhe gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbrojtës për të rritur aftësinë e tyre në të kuptuarit e çështjeve ligjore që kanë të bëjnë me gjykimet për krime të luftës. Ato do t’i bëjnë që vendimet e marra nga kjo gjykatë të jenë më bindëse. Në fund, vendimet e tilla do të ndihmojnë në themelimin e bazave për një gjyqësi më dinamike dhe më të pavarur të Kosovës.

PJESA V. STATISTIKAT MBI RASTET E KRIMEVE TË LUFTËS

Rastet e krimeve të luftës				
• Bazuar në statistikat që i kishte në dispozicion SMSJ-ja më 1 korrik 2002				
Statusi	<u>Gjenocid</u>	<u>Krime Luftë</u>	<u>Vrasje</u>	
Nën hetime	0	4	0	
Hetimet e ndërprera	1	0	0	
Aktakuza e ngritur	10	17	6	
Heqje dorë nga aktakuza	2	0	0	
Aktgjykimi i parë	Fajtor	3*	5*	6
	Nuk është fajtor	0	7	0
Rigjykimi Aktgjykimi	Fajtor	0	1	3
	Nuk është fajtor	2	1	1
Gjykimi vazhdon	0	0	0	
Rigjykimi vazhdon	0	2	1	
Të ikur	5	4	0	
Në arrati	0	2	1	

-
- Për dy të pandehurit fillimisht ishte ngritur aktakuza për gjenocid, mirëpo ata dënohen për vepra penale më të lehta
 - Për dy të pandehurit fillimisht ishte ngritur aktakuza për krime lufte, mirëpo ata mëpastaj dënohen për vepra penale më të lehta.

Aktgjykimet në rradhitje kronologjike

Data	I pandehuri	Përbërja e Kolegjit	Aktgjykimi
3 korrik 2000	Nikoliq (gjykimi i parë)	vendës	Fajtor
9 gusht 2000	Simiq	vendës	Fajtor
30 gusht 2000	Ademi	vendës	Fajtor
13 shtator 2000	I mituri Z	vendës	Fajtor
20 shtator 2000	Jokiq (gjykimi i parë)	vendës	Fajtor
9 tetor 2000	Ajeti	vendës	Fajtor
	Stojanoviq		Fajtor
18 janar 2001	Vuqkoviq	vendës	Fajtor
	Bishevac		Fajtor
29 janar 2001	Matiq (gjykimi i parë)	ndërkombëtar	Fajtor (për akuzë më të lehtë)
6 mars 2001	Trajkoviq	vendës	Fajtor
10 prill 2001	Simiq dhe tjerët	vendës	Hjeket dorë nga ndjekja
14 qershor 2001	Jovanoviq	ndërkombëtar	Fajtor
	Kollashinac		Fajtor (për akuzë më të lehtë)
18 qershor 2001	Stanojeviq	ndërkombëtar	Fajtor
2 nëntor 2001	Misiq	ndërkombëtar	Nuk është fajtor
	Jovanoviq		Nuk është fajtor
23 nëntor 2001	Mlladenoviq	ndërkombëtar	Nuk është fajtor
28 janar 2002	Apostoloviq	ndërkombëtar	Nuk është fajtor
27 mars 2002	Matiq (rigjykim)	ndërkombëtar	Nuk është fajtor
18 prill 2002	Nikolliq (rigjykim)	ndërkombëtar	Nuk është fajtor
3 maj 2002	Jokiq (rigjykim)	ndërkombëtar	Nuk është fajtor

Vendimet e Gjykatës Supreme në rradhitje kronologjike

DATA	I PANDEHURI	PËRBËRJA E KOLEGJIT	VENDIMI
8 mars 2001	I mituri Z	Vendës	Vërtetuar
9 prill 2001	Nikoliq	Ndërkombëtar	Kthyer në rishqyrtim
9 prill 2001	Vuqkoviq	Ndërkombëtar	Kthyer në rishqyrtim
26 prill 2001	Jokiq	Ndërkombëtar	Kthyer në rishqyrtim
6 qershor 2001	Zvezdan Simiq	Ndërkombëtar	Vërtetuar
13 qershor 2001	Matiq	Ndërkombëtar	Kthyer në rishqyrtim
29 nëntor 2001	Jovanoviq	Ndërkombëtar	Vërtetuar
	Kollashinac		Kthyer në rishqyrtim
29 nëntor 2001	Ajeti	Ndërkombëtar	Kthyer në rishqyrtim
	Stojanoviq		Kthyer në rishqyrtim
30 nëntor 2001	Trajkoviq	Ndërkombëtar	Kthyer në rishqyrtim
18 janar 2002	Stanojeviq	Ndërkombëtar	Vërtetuar

Dispozitat relevante të Ligjit Penal të RFJ-së

LP RFJ 141. Gjenocidi

Kush me qëllim për të zhdukur tërësisht apo pjesërisht ndonjë grup nacional, etnik, racial apo fetar urdhëron që të bëhen vrasje apo plagosje të rënda ose dëmtim i rëndë i shëndetit fizik apo shpirtëror të personave të grupit apo bën shpërngulje të dhunshme të popullsisë, ose e vën grupin në kushte të atilla jetese që sjellin shfarosjen e plotë ose të pjesërishtme të grupit, ose zbaton masa me të cilat ndalohen lindjet midis pjesëtarëve të grupit, apo bën shpërnguljen e dhunshme të fëmijëve në një grup tjetër, ose kush për të njëjtin qëllim kryen ndonjë nga veprat penale të lartpërmendura, do të dënohet të paktën me pesë vjet burg ose me dënimin me vdekje.

LP RFJ 142. KRIME LUFTE KUNDËR POPULLATËS CIVILE

Kush duke shkelur rregullat e të drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, të konfliktit të armatosur ose okupacionit, urdhëron që kundër popullsisë civile të bëhen vrasje, tortura, shjellje jonjerëzore, eksperimente biologjike, shkaktim i vuajtjeve të mëdha ose cënime të integritetit trupor apo të shëndetit; shpërngulje apo transferime apo

shkombëtarizime me dhunë ose kthimi në ndonjë fe tjetër; shtrëngime për tu marrë me prostitucion ose kryen dhunime seksuale; aplikimin e masave të frikësimit dhe terrorit, marrjen e njerëzve peng, ndëshkime kolektive, dërgimin e kundërligjshëm në kampet e përqëndrimit dhe kryen paraburgime të tjera të kundërligjshme, privimin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; shtrëngime për të shërbyer në forcat e armatosura të forcës armike ose në shërbimin e saj informativ ose në administratën e saj; shtrëngime për të bërë punë të detyrueshme, lënien e popullsisë në uri; konfiskime të pasurisë, grabitje të pasurisë së popullsisë, asgjësimin e kundërligjshëm dhe arbitrar apo përvetësimin në masë të madhe të pasurisë që nuk arsyetohet me nevojat ushtarake, merr kontribute dhe kryen rekuizime të paligjshme e në përpjestime të mëdha, kryen uljen e vlerës së parave të vendit ose emetimin e kundërligjshëm të parave, ose kush kryen ndonjë nga veprat e lartpërmendura, do të dënohet të paktën me pesë vjet burg ose me dënimin me vdekje.